

Skender Asani, Albert Ramaj
Скендер Асани, Алберт Рамај





UDHA MISIONARE E GONXHE BOJAXHIUT DREJT NËNË TEREZËS UNIVERSALE

МИСИОНЕРСКИОТ ПАТ НА ГОНЏЕ БОЈАЏИУ КОН УНИВЕРЗАЛНАТА МАЈКА ТЕРЕЗА

THE MISSIONARY JOURNEY OF GONXHE BOJAXHIU TOWARD THE UNIVERSAL MOTHER MOTHER TERESA

SHKUP / СКОПЈЕ / SKOPJE 2026

Qendra për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore
Центар за духовно и културно наследство
Center for Spiritual and Cultural Heritage

Skender Asani, Albert Ramaj

UDHA MISIONARE E GONXHE BOJAXHIUT DREJT NËNË TEREZËS UNIVERSALE

(*“Katoličke Misije” dhe “Blagovest”*)

Скендер Асани, Алберт Рамај

МИСИОНЕРСКИОТ ПАТ НА ГОНЏЕ БОЈАЏИУ КОН УНИВЕРЗАЛНАТА МАЈКА ТЕРЕЗА

(*„Katoličke Misije“ и „Blagovest“*)

Skender Asani, Albert Ramaj

THE MISSIONARY JOURNEY OF GONXHE BOJAXHIU TOWARD THE UNIVERSAL MOTHER TERESA

(*“Katoličke Misije” and “Blagovest”*)

Shkup / Скопје / Skopje
2026

Botues: Qendra për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore
Издавач: Центар за духовно и културно наследство
Publisher: Center for Spiritual and Cultural Heritage

Redaktor: Sevdail Demiri
Уредник: Севдаиљ Демири
Editor: Sevdail Demiri

Përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe maqedonase nga Florentina Krasniqi

Recensentë: Don Lush GJERGJI, Martin BERISHAJ
Рецензенти: Дон Луш ЃЕРЃИ, Мартин БЕРИШАЈ
Reviewers: Don Lush GJERGJI, Martin BERISHAJ

ISBN: 978-608-67625-0-6
Të drejtat e rezervuara©Qendra për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore

Ky libër botohet nën kujdesin e z. Bekim Sali, Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër për Çështje Evropiane i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Оваа книга се издава под покровителство на г. Беким Сали,
Прв заменик-претседател на Владата и министер за европски прашања на Република Северна Македонија

This book is published under the auspices of Mr. Bekim Sali, First Deputy Prime Minister and Minister for European Affairs of the Republic of North Macedonia

Skender Asani, Albert Ramaj

Udha misionare e Gonxhe Bojaxhiut drejt Nënë Terezës universale

(“Katoličke Misije” dhe “Blagovest”)

Скендер Асани, Алберт Рамај

Мисионерскиот пат на Гонџе Бојациу кон универзалната Мајка Тереза

(„Katoličke Misije“ и „Blagovest“)

Skender Asani, Albert Ramaj

The Missionary Journey of Gonxhe Bojaxhiu toward the Universal Mother Teresa

(“Katoličke Misije” and “Blagovest”)

PËRMBAJTJEN

HYRJE 11
KAPITULLI I PARË 31
I. Lindja e një ndërgjegjeje universale 31

KAPITULLI I DYTË 109
II. Nga Gonxhja shqiptare e Shkupit drejt Nënë Terezës universale: transformimi i një identiteti misionar në dritën e revistës "Katoličke Misije" (1928–1942) 109
II.I. Misionet Katolike 127
II.II. Çfarë shkruajnë misionarët tanë 135
II.III. Fletë nga misionet 142
II.IV. Misionaret e reja 153
II.V. Fotografi nga Kalkuta 154
II.VI. dy rrëfime të jashtëzakonshme 155
II.VII. Entali – Kalkutë 165

KAPITULLI I TRETË 167
III.I. Misionet 167
III.II. 179
III.III. 180
III.IV. 182
III.V. Vizita e Misionares nga India 184
III.VI. 190
III.VII. Mirënjohje e Merituar për Nënë Terezën 192
III.VIII. Motër Magdalena nga India 202
III.IX. 206
III.X. 207
III.XI. Nënë Tereza Lajmëtarja e kohëve të reja 209
III.XII. Motra Gabriela Anastazija Mihillit. Misionare në Indi 216

III.XIII. 223
III.XIV. 224
III.XV. Nënë tereza – Zëri i Ndërgjegjes 226
III.XVI. 250
III.XVII. 251
III.XVIII. Lajm i gëzueshëm për Nënë Terezën! 252
III.XIX Dëshmitarë të Krishtit 263
III.XX. 274
III.XXI. Çmimi Nobel për Nënë Terezën 275
III.XXII. Nënë Tereza në Atdhe 282
III.XXIII. Nënë Tereza merr Çmimin Nobel në Oslo 289
III.XXIV. Dorëzimi i Çmimit Nobel 291
III.XXV. Tre letra të Nënë Terezës 298

RECENSION 325
RIKTHIMI TE BURIMET - RIKTHIMI TE E VËRTETA E THIRRJES - Don Lush GJERGJI 325

RECENSION 338
DOKUMENTET NËN HIJEN E HESHTJES
-Prof. Dr. Martin BERISHAJ 338

СОДРЖИНА

ВОВЕД 17
ГЛАВА ПРВА 59
I. Раѓањето на една универзална свест 59

ГЛАВА ВТОРА 115
II. Од албанската Гонџа од Скопје до универзалната Мајка Тереза: трансформацијата на еден мисионерски идентитет во светлината на списанието “Katoličke Misije” (1928–1942) 115
II.I. Католички мисии 129
II.II. Што пишуваат нашите мисионерки 137
II.III. Листови од мисиите 145
II.IV. Младите мисионерки 153
II.V. Фотографии од Калкута 154
II.VI. Две необични сведоштва 157
II.VII Ентали – Калкута: 165

ГЛАВА ТРЕТА 171
III.I. Мисиите 171
III.II. 179
III.III. 180
III.IV. 182
III.V Посета на мисионерката од Индија 186
III.VI. 190
III.VII. Заслужено признание на Мајка Тереза 195
III.VIII. Сестра Магдалена од Индија 203
III.IX. 206
III.X. 207
III.XI. Мајка Тереза, Гласник на новото време 211

III.XII. Сестра Габриела Анастазија Михил. Мисионерка во Индија 218
III.XIII. 223
III.XIV. 224
III.XV. Мајка Терезија глас на совеста 233
III.XVI. 250
III.XVII. 251
III.XVIII.Благовест за Мајка Терезија! 255
III.XIX. Христови сведоци 266
III.XX. 274
III.XXI. Нобелова награда за Мајка Тереза 277
III.XXII. Мајка Тереза во татковината 284
III.XXIII. Мајка Тереза ја прима Нобеловата награда во Осло 289
III.XXIV. Врачување на Нобеловата награда 293
III.XXV. Три писма од Мајка Тереза 305

РЕЦЕНЗИЈА 329
ВРАЌАЊЕ КОН ИЗВОРИТЕ - ВРАЌАЊЕ КОН ВИСТИНАТА НА ПОВИКОТ - Дон Луш ЃЕРЃИ 329

РЕЦЕНЗИЈА 351
ДОКУМЕНТИ ВО СЕНКАТА НА МОЛКОТ - Проф. д-р Мартин БЕРИШАЈ 351

CONTENTS

PREFACE 23
CHAPTER ONE 83
I. The Birth of a Universal Consciousness 83

CHAPTER TWO 121
II. From the Albanian Gonxhe of Skopje to the Universal Mother Teresa: The Transformation of a Missionary Identity in the Light of the Journal "Katoličke Misije" (1928–1942) 121
II.I. Catholic Missions 131
II.II. What Our Missionaries Write 139
II.III. Letters from the Missions 148
II.IV. The New Missionaries 153
II.V Photos of Calcutta 154
II.VI. Two extraordinary accounts 160
II.VII. Entally – Calcutta 165

CHAPTER THREE 175
III.I. MISSIONS 175
III.II. 179
III.III. 180
III.IV. 182
III.V. Visit of The Missionary from India 188
III.VI. 190
III.VII. A Well-deserved recognition for Mother Teresa 198
III.VIII. Sister Magdalena from India 204
III.IX. 206
III.X. 207
III.XI. Mother Teresa A Herald of New Times 213

III.XII. Sister Gabriela Anastazija Mihillit.
Missionary in India 220
III.XIII. 223
III.XIV 224
III.XV. Mother Teresa – The voice of Conscience 239
III.XVI. 250
III.XVII. 251
III.XVIII. Glad tidings about Mother Teresa! 258
III.XIX. Witnesses of Christ 269
III.XX. 274
III.XXI. The Nobel Prize for Mother Teresa 279
III.XXII. Mother Teresa in Her Homeland 286
III.XXIII. Mother Teresa Receives the Nobel Prize in Oslo 289
III.XXIV. The Presentation of the Nobel Prize 295
III.XXV. Three Letters of Mother Teresa 312

REVIEW 333
RETURNING TO THE SOURCES - RETURNING TO THE TRUTH OF A VOCATION - Don Lush GJERGJI 333

REVIEW 365
DOCUMENTS IN THE SHADOW OF SILENCE 365
- Prof. Dr. Martin BERISHAJ

HYRJE

Drejt burimeve që dokumentojnë lindjen e një misioni universal

Ka figura historike, jeta e të cilave kapërcen kufijtë e biografisë dhe shndërrohet në pjesë të kujtesës universale të njerëzimit. Në mesin e tyre, një vend të veçantë zë Gonxhe Bojaxhiu vajza shqiptare e lindur në Shkup, e cila, përmes një rrugëtimi të gjatë shpirtëror, njerëzor dhe misionar, u bë Nënë Tereza, simboli më i njohur botëror i mëshirës, dashurisë dhe shërbimit ndaj njeriut. Megjithatë, çdo përpjekje për ta kuptuar këtë transformim në tërësinë e tij historike nuk mund të mbështetet vetëm në kujtimet e mëvonshme, në biografitë retrospektive apo në interpretimet hagiografike. Historia e saj kërkon rikthimin te burimet, te dokumentet bashkëkohore, te dëshmitë që u shkruan në kohën kur ngjarjet po ndodhnin dhe që ruajnë autenticitetin e fjalës, emocionit dhe përjetimit.

Pikërisht kjo bindje përbën themelin metodologjik të këtij libri.

Nxitja për të ndërmarrë këtë hulumtim erdhi nga një prej studiuesve dhe njohësve më të thellë të jetës dhe veprës së Nënë Terezës, Don Lush Gjergji, i cili prej dekadash ka theksuar se fillesat e misionit të saj nuk mund të kuptohen plotësisht pa u kthyer te periodikët katolikë që e kanë ndjekur hap pas hapi rrugëtimin e saj. Sipas tij, kush dëshiron të depërtojë në historinë dokumentare të Gonxhe Bojaxhiut duhet të hulumtojë me kujdes faqet e revistës "Katoličke Misije", të botuar në Zagreb, sepse pikërisht aty ruhen dëshmitë më të hershme mbi lindjen e thirrjes së saj misionare.

Ky sugjerim nuk ishte vetëm një orientim bibliografik, por ai u shndërrua në pikënisjen e një kërkimi të ri historiografik.

Realizimi i këtij hulumtimi nuk do të kishte qenë i mundur pa mbështetjen e vyer të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Kroacisë, Prof. Dr. Martin Berisha, i cili me përkushtim institucional mundësoi qasjen në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Zagrebit. Falë angazhimit të tij u bë e mundur konsultimi sistematik i koleksioneve të plota të revistës "Katoličke Misije", ku ruhen disa nga dokumentet më të hershme dhe më autentike që dëshmojnë nisjen e rrugëtimit misionar të Gonxhe Bojaxhiut.

Në ato faqe ende nuk gjendet figura e shenjtores që do të nderohej më vonë nga mbarë bota. Aty gjendet një vajzë shqiptare nga Shkupi, e cila largohet nga familja, nga vendlindja dhe nga gjithçka që kishte njohur, për t'iu përgjigjur një thirrjeje që e ndiente si vullnet të Hyjit. Revista ndjek kronologjikisht largimin e saj drejt Irlandës, letrat nga Dublini, mbërritjen në Indi, përvojën e parë në Kongregatën e Loretos, përballjen me kulturën e re, sfidat e misionit dhe rritjen e saj të pandërprerë shpirtërore. Çdo letër, çdo fotografi dhe çdo kronikë e botuar në kohën kur ngjarjet zhvilloheshin përbën sot një dokument historik me vlerë të pazëvendësueshme.

Megjithatë, kërkimi nuk mund të ndalej vetëm në Zagreb.

Hulumtimet e zhvilluara në bibliotekat e Shkupit sollën në dritë një korpus tjetër dokumentar po aq të rëndësishëm: revistën "Blagovest" (Blagovijest), organin zyrtar të Dioqezës Shkup–Prizren, të themeluar në vitin 1928 nga Ipeshkvi Janez Gnidovec. Nëse "Katoličke Misije" dokumenton lindjen dhe zhvillimin e parë të thirrjes misionare në dimensionin universal të Kishës, "Blagovest" ruan kujtesën lokale të komunitetit ku kjo thirrje u formësua. Këto dy revista nuk qëndrojnë përballë njëra-tjetrës, por plotësojnë njëra-tjetrën dhe krijojnë së bashku një korpus unik dokumentar, pa të cilin rrugëtimi i Gonxhe Bojaxhiut nuk mund të rindërtohet në mënyrë të plotë.

Historia shpesh shkruhet pasi ngjarjet kanë përfunduar. Por ekzistojnë edhe raste të rralla kur historia lind paralelisht me vetë ngjarjet. Pikërisht kësaj kategorie i përket rrugëtimi i Gonxhe Bojaxhiut. Ai nuk u ndërtua vetëm nga kujtesa retrospektive, por u regjistrua hap pas hapi në faqet e këtyre dy periodikëve katolikë, të cilët u bënë kronistët e heshtur të një transformimi që askush nuk mund ta parashikonte.

Kur në vitin 1928 Ipeshkvi Janez Gnidovec themeloi revistën "Blagovest", askush nuk mund ta merrte me mend se faqet e saj do të shndërroheshin në kronikën më të hershme të lindjes së një misioni universal. Revista

kishte për qëllim forcimin e jetës shpirtërore të besimtarëve të Dioqezës Shkup–Prizren, promovimin e thirrjeve meshtarake dhe rregulltare dhe mbajtjen gjallë të lidhjes me misionet katolike në botë. Por historia i rezervoi një mision shumë më të madh: të ruante kujtesën dokumentare të vajzës shqiptare nga Shkupi që do të bëhej Nënë Tereza.

Në faqet e "Blagovest" nuk paraqitet fillimisht figura e shenjtë. Aty shfaqet Gonxhja vajza e re e formuar në Kishën e Zemrës së Krishtit, e edukuar në frymën e Kongregatës Mariane dhe e ushqyer shpirtërisht nga rrëfimet e misionarëve që revista botonte rregullisht. Letrat nga India, Afrika e Kina nuk ishin vetëm lajme kishtare, por ato zgjonin tek të rinjtë bindjen se Ungjilli nuk njeh kufij dhe se shërbimi ndaj tjetrit është forma më e lartë e dëshmisë së fesë.

Në këtë kuptim, "Katoličke Misije" dhe "Blagovest" nuk ishin vetëm revista që informonin mbi misionet. Ato u bënë pjesë e vetë procesit të formimit shpirtëror të Gonxhes. Pikërisht në faqet e tyre ajo njohu botën misionare shumë kohë përpara se ta shihte me sytë e saj. Rrëfimet e misionarëve zgjuan tek ajo dëshirën për t'u shërbyer më të varfërve dhe e orientuan drejt një horizonti që shtrihej shumë përtej kufijve të qytetit ku kishte lindur.

Nuk është rastësi që, sapo u nis drejt misionit, edhe vetë Gonxhja u bë autore e këtyre revistave.

Letrat e saj nga Dublini, Darjeelingu dhe Kalkuta u botuan pothuajse menjëherë, duke krijuar një lidhje të pazakontë ndërmjet lexueses dhe autores. Ajo që dikur frymëzohej nga faqet e këtyre periodikëve, tashmë frymëzonte të tjerët përmes të njëjtave faqe. Ky kalim nga lexuesja te dëshmitarja përbën një nga aspektet më domethënëse të historisë së saj dhe njëkohësisht një dëshmi të rrallë mbi mënyrën se si një kulturë misionare riprodhon vetveten.

Në vitin 1929 "Blagovest" botoi letrën e saj të parë, të shkruar gjatë udhëtimit drejt Indisë. Për herë të parë besimtarët e Shkupit dëgjuan zërin e një misionareje të re, e cila nuk rrëfente vetëm një udhëtim gjeografik, por edhe lindjen e një udhëtimi të brendshëm. Më pas revista vazhdoi të publikonte letra, kronika dhe dëshmi që lejonin ndjekjen kronologjike të zhvillimit të saj shpirtëror.

Në dhjetor të vitit 1932, "Blagovest" e vendosi Gonxhe Bojaxhiun pranë Motrës Gabriela Anastazija Mihillit dhe Anës, si tri vajza shqiptare të lidhura me jetën misionare. Ky nuk ishte një vlerësim retrospektiv, por një dëshmi

bashkëkohore që tregon se komuniteti katolik i Shkupit e kishte kuptuar tashmë rëndësinë e misionit të tyre.

Në vitet pasuese revista vazhdoi të ruante kujtesën e këtij rrugëtimi. Letrat nga Loreto Convent në Entally, dëshmitë e Motrës Gabriela Anastazija Mihillit dhe materialet e ribotuara pas Luftës së Dytë Botërore zbulojnë botën e brendshme të Motrës Terezë: përkushtimin, sakrificën, heshtjen, errësirën shpirtërore dhe besimin e palëkundur që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës.

Kur më vonë bota njohu laureaten e Çmimit Nobel për Paqen, "Blagovest" nuk kishte nevojë ta zbulonte figurën e saj. Revista e njihte prej kohësh. Ajo kishte qenë dëshmitare e lindjes së këtij misioni shumë kohë përpara se bota ta njihte emrin Nënë Terezë.

Pikërisht këtu qëndron rëndësia historiografike e këtyre dy revistave.

Në metodologjinë bashkëkohore të kërkimit historik, burimet primare kanë peshën më të madhe, sepse ato nuk ndërtojnë kujtesën pas ngjarjes, por e regjistrojnë atë në çastin kur historia po zhvillohet. Dokumentet e botuara në "Katoličke Misije" dhe "Blagovest" nuk janë interpretime të mëvonshme. Ato ruajnë gjuhën e kohës, emocionin e përjetimit, kronologjinë autentike dhe autenticitetin e dëshmitarit. Pikërisht kjo i bën ato burime të pazëvendësueshme për historiografinë moderne mbi jetën e Nënë Terezës.

Në të njëjtën kohë, këto revista hedhin dritë edhe mbi mjedisin ku u formua personaliteti i saj. Historia e Nënë Terezës nuk fillon në Kalkutë. Ajo fillon në Shkup. Fillon në familjen Bojaxhiu. Fillon në Kishën e Zemrës së Krishtit, ku Gonxhja u edukua në frymën e shërbimit dhe të solidaritetit. Fillon në Kongregatën Mariane, ku u ushqye ideali i saj apostolik. Dhe fillon në faqet e "Katoličke Misije" dhe "Blagovest", ku për herë të parë u dokumentua me gjuhën e kohës lindja e një thirrjeje që do të bëhej universale.

Ky libër lindi nga bindja se këto materiale nuk duhet të mbeten të shpërndara në koleksione bibliotekash apo të njohura vetëm nga një rreth i ngushtë studiuesish. Qëllimi i tij është t'i bashkojë ato në një tërësi të vetme dokumentare, duke krijuar për herë të parë një narrativë të plotë kronologjike të transformimit të Gonxhe Bojaxhiut në Nënë Terezën universale.

Në prag të vitit 2028, kur mbushen njëqind vjet nga nisja e saj drejt misionit, rikthimi te këto burime merr një domethënie të veçantë. Nuk është vetëm një ushtrim historiografik, por një akt kujtese, përgjegjësie shkencore dhe ndërgjegjeje kulturore. Ai synon të rikthejë në qendër të vëmendjes jo

vetëm figurën e Nënë Terezës, por edhe botën shpirtërore, kulturore dhe kishtare që e lindi këtë figurë.

Në fund të fundit, ky është edhe misioni themelor i këtij libri. Të dëshmojë se historia e Nënë Terezës nuk është vetëm historia e një shenjtoreje. Ajo është historia e një thirrjeje, e një komuniteti, e një kulture shpirtërore dhe e një identiteti që, duke u nisur nga Shkupi, arriti të prekë ndërgjegjen e mbarë njerëzimit. Prandaj, "Katoličke Misije" dhe "Blagovest" nuk janë vetëm dy revista të historisë së Kishës Katolike në Ballkan. Ato janë dy dëshmitare të lindjes së një misioni universal. Njëra dokumentoi në kohë reale fillesën e thirrjes misionare; tjetra ruajti kujtesën, vazhdimësinë dhe identitetin e saj përgjatë dekadave. Së bashku ato formojnë një korpus unik dokumentar, pa të cilin transformimi i Gonxhe Bojaxhiut në Nënë Terezën universale nuk mund të kuptohet në tërësinë e tij historike, akademike dhe shpirtërore.

Ky është misioni i këtij libri. Kjo është edhe ftesa që ai i drejton lexuesit: të rikthehet te burimet, sepse vetëm burimet e ruajnë të paprekur të vërtetën e historisë.

Nga autorët

ВОВЕД

Кон изворите што го документираат раѓањето на една универзална мисија

Постојат историски личности чиј живот ги надминува границите на биографијата и се претвора во составен дел од универзалната меморија на човештвото. Меѓу нив посебно место зазема Гонџе Бојаџиу, албанската девојка родена во Скопје, која преку едно долго духовно, човечко и мисионерско патување стана Мајка Тереза најпрепознатливиот светски симбол на милосрдието, љубовта и служењето на човекот. Сепак, секој обид оваа преобразба да се разбере во нејзината целосна историска димензија не може да се заснова само врз подоцнежните сеќавања, ретроспективните биографии или врз идеализираните религиозни толкувања. Нејзината историја бара враќање кон изворите, кон современите документи и кон сведоштвата напишани во времето кога настаните се случувале, кои ја зачувале автентичноста на зборот, чувството и доживувањето.

Токму ова уверување ја претставува методолошката основа на оваа книга.

Поттикот за започнување на ова истражување произлезе од еден од најдлабоките истражувачи и познавачи на животот и делото на Мајка Тереза, дон Луш Ѓерѓи, кој со децении нагласува дека почетоците на нејзината мисија не можат целосно да се разберат без враќање кон католичките периодични изданија што чекор по чекор го следеле нејзиниот животен пат. Според него, секој што сака да проникне во документарната историја на Гонџе Бојаџиу треба внимателно да ги истражува страниците на списанието “Katoličke Misije”, издавано во Загреб, бидејќи токму таму се зачу-

вани најраните сведоштва за раѓањето на нејзиниот мисионерски повик.

Овој предлог не претставуваше само библиографска насока; тој се претвори во појдовна точка на едно ново историографско истражување.

Реализирањето на ова истражување немаше да биде возможно без драгоцената поддршка на амбасадорот на Република Косово во Република Хрватска, проф. д-р Мартин Бериша, кој со својата институционална посветеност овозможи пристап до Националната и универзитетска библиотека во Загреб. Благодарение на неговиот ангажман беше овозможено систематско проучување на целосните збирки на списанието "Katoličke Misije", во кои се чуваат некои од најраните и најавтентични документи што сведочат за почетокот на мисионерското патување на Гонџе Бојациу.

На тие страници сè уште не ја среќаваме светителката која подоцна ќе биде почитувана од целиот свет. Таму ја среќаваме младата Албанка од Скопје, која го напушта семејството, родниот град и сè што дотогаш го познавала, за да одговори на повикот што го чувствувала како Божја волја. Списанието хронолошки го следи нејзиното заминување кон Ирска, писмата од Даблин, пристигнувањето во Индија, првите искуства во Лоретанската конгрегација, соочувањето со новата култура, предизвиците на мисијата и нејзиното непрекинато духовно растење. Секое писмо, секоја фотографија и секоја хроника објавена во времето кога настаните се одвивале, денес претставува историски документ со незаменлива вредност.

Сепак, истражувањето не можеше да запре само во Загреб.

Истражувањата спроведени во библиотеките во Скопје изнесоа на виделина уште еден, подеднакво значаен документарен корпус: списанието „Благовест" / "Blagovest" или „Blagovijest" официјален орган на Скопско-призренската бискупија, основан во 1928 година од бискупот Јанез Гнидовец. Доколку "Katoličke Misije" го документира раѓањето и почетниот развој на мисионерскиот повик во универзалната димензија на Црквата, „Благовест" ја зачувува локалната меморија на заедницата во која тој повик се обликувал. Овие две списанија не стојат спротивставени едно на друго; тие заемно се надополнуваат и заедно создаваат единствен документарен корпус, без кој животниот пат на Гонџе Бојациу не може целосно да се реконструира.

Историјата честопати се пишува откако настаните веќе завршиле. Но постојат и ретки случаи кога историјата се раѓа истовремено со сами-

те настани. Токму на оваа категорија ѝ припаѓа животниот пат на Гонџе Бојаџиу. Тој не беше создаден само преку ретроспективното сеќавање, туку чекор по чекор беше забележуван на страниците на овие две католички периодични изданија, кои станаа тивки хроничари на една преобразба што никој во тоа време не можеше да ја предвиди.

Кога во 1928 година бискупот Јанез Гнидовец го основал списанието „Благовест“, никој не можел да претпостави дека неговите страници ќе се претворат во најраната хроника за раѓањето на една универзална мисија. Списанието имало цел да го зајакне духовниот живот на верниците во Скопско-призренската бискупија, да ги промовира свештеничките и монашките повици и да ја одржува жива врската со католичките мисии низ светот. Но историјата му определи многу поголема мисија: да ја зачува документарната меморија за албанската девојка од Скопје, која ќе стане Мајка Тереза.

На страниците на „Благовест“ во почетокот не се појавува ликот на светителката. Таму се појавува Гонџе младата девојка духовно формирана во црквата „Пресвето Срце Исусово“, воспитана во духот на Маријанската конгрегација и духовно хранета од раскажувањата на мисионерите што списанието редовно ги објавувало. Писмата од Индија, Африка и Кина не биле само црковни вести; тие кај младите го буделе уверувањето дека Евангелието не познава граници и дека служењето на другиот е највозвишената форма на сведочење на верата.

Во оваа смисла, “Katoličke Misije” и „Благовест“ не биле само списанија што информирале за мисиите. Тие станале дел од самиот процес на духовното формирање на Гонџе. Токму на нивните страници таа го запознала мисионерскиот свет многу порано отколку што го видела со сопствените очи. Раскажувањата на мисионерите кај неа ја разбудиле желбата да им служи на најсиромашните и ја насочиле кон еден хоризонт што се простирал многу подалеку од границите на градот во кој била родена.

Не е случајно што, веднаш откако тргнала кон мисијата, и самата Гонџе станала авторка во овие списанија.

Нејзините писма од Даблин, Дарџилинг и Калкута биле објавувани речиси веднаш, создавајќи една необична врска меѓу читателката и авторката. Онаа што некогаш била инспирирана од страниците на овие периодични изданија, сега ги инспирирала другите преку истите тие страници.

Овој премин од читателка во сведок претставува еден од најзначајните аспекти на нејзината историја, а истовремено и ретко сведоштво за начинот на кој една мисионерска култура се обновува и се пренесува самата себеси.

Во 1929 година „Благовест“ го објавил нејзиното прво писмо, напишано за време на патувањето кон Индија. За првпат верниците во Скопје го слушнале гласот на една млада мисионерка, која не раскажувала само за едно географско патување, туку и за раѓањето на едно внатрешно духовно патување. Потоа списанието продолжило да објавува писма, хроники и сведоштва што овозможувале хронолошко следење на нејзиниот духовен развој.

Во декември 1932 година „Благовест“ ја претставил Гонџе Бојаџиу заедно со сестра Габриела Анастазија Михилит и Ана, како три албански девојки поврзани со мисионерскиот и монашкиот живот. Тоа не било ретроспективна оцена, туку современо сведоштво што покажува дека католичката заедница во Скопје уште тогаш го препознала значењето на нивната мисија.

Во следните години списанието продолжило да го зачувува сеќавањето за ова патување. Писмата од манастирот Лорето во Ентали, сведоштвата на сестра Габриела Анастазија Михилит и материјалите повторно објавувани по Втората светска војна го откриваат внатрешниот свет на сестра Тереза: нејзината посветеност, жртвата, молчењето, духовната темнина и непоколебливата вера што ќе ја придружува во текот на целиот живот.

Кога подоцна светот ја запозна добитничката на Нобеловата награда за мир, „Благовест“ немал потреба допрва да го открива нејзиниот лик. Списанието одамна ја познавало. Тоа било сведок на раѓањето на оваа мисија многу пред светот да го запознае името Мајка Тереза.

Токму во тоа се состои историографското значење на овие две списанија.

Во современата методологија на историското истражување, примарните извори имаат најголема тежина, бидејќи тие не ја создаваат меморијата по завршувањето на настанот, туку го регистрираат во моментот кога историјата се одвива. Документите објавени во “Katoličke Misije” и „Благовест“ не се подоцнежни интерпретации. Тие го зачувуваат јазикот на времето, емоцијата на доживувањето, автентичната хронологија и веро-

достојноста на сведокот. Токму тоа ги прави незаменливи извори за современата историографија посветена на животот на Мајка Тереза.

Истовремено, овие списанија фрлаат светлина и врз средината во која се формирала нејзината личност. Историјата на Мајка Тереза не започнува во Калкута. Таа започнува во Скопје. Започнува во семејството Бојаџиу. Започнува во црквата „Пресвето Срце Исусово“, каде што Гонџе била воспитана во духот на служењето и солидарноста. Започнува во Маријанската конгрегација, каде што бил негуван нејзиниот апостолски идеал. И започнува на страниците на “Katoličke Misije” и „Благовест“, каде што за првпат, со јазикот на времето, било документирано раѓањето на еден повик што подоцна ќе стане универзален.

Оваа книга произлезе од уверувањето дека овие материјали не треба да останат расфрлани низ библиотечните збирки или познати само на тесен круг истражувачи. Нејзината цел е да ги обедини во една единствена документарна целина, создавајќи за првпат целосен хронолошки наратив за преобразбата на Гонџе Бојаџиу во универзалната Мајка Тереза.

Во пресрет на 2028 година, кога ќе се одбележат сто години од нејзиното заминување во мисијата, враќањето кон овие извори добива посебно значење. Тоа не претставува само историографска постапка, туку и чин на сеќавање, научна одговорност и културна свест. Неговата цел е во центарот на вниманието да ја врати не само личноста на Мајка Тереза, туку и духовниот, културниот и црковниот свет од кој произлегла оваа исклучителна фигура.

На крајот, тоа е и основната мисија на оваа книга. Да посведочи дека историјата на Мајка Тереза не е само историја на една светителка. Таа е историја на еден повик, на една заедница, на една духовна култура и на еден идентитет кој, тргнувајќи од Скопје, успеа да ја допре совеста на целото човештво.

Затоа, “Katoličke Misije” и „Благовест“ не се само две списанија од историјата на Католичката црква на Балканот. Тие се два сведока на раѓањето на една универзална мисија. Едното во реално време ги документирало почетоците на мисионерскиот повик; другото ги зачувало неговата меморија, континуитетот и идентитетот низ деценииите. Заедно тие создаваат единствен документарен корпус, без кој преобразбата на Гонџе

Бојациу во универзалната Мајка Тереза не може да се разбере во нејзината историска, академска и духовна целост.

Тоа е мисијата на оваа книга. Тоа е и поканата што таа му ја упатува на читателот: да се врати кон изворите, бидејќи само изворите ја зачувуваат недопрена вистината на историјата.

Од авторите

PREFACE

Towards the Sources that Document the Birth of a Universal Mission

There are historical figures whose lives transcend the boundaries of biography and become part of the universal memory of humankind. Among them, a distinctive place belongs to Gonxhe Bojaxhiu, the Albanian girl born in Skopje, who, through a long spiritual, human, and missionary journey, became Mother Teresa the world's most recognized symbol of mercy, love, and service to humanity. Yet every attempt to understand this transformation in its full historical dimension cannot rely solely on later recollections, retrospective biographies, or idealized devotional interpretations. Her story demands a return to the sources: to contemporary documents and testimonies written while the events themselves were unfolding, preserving the authenticity of language, emotion, and lived experience.

It is precisely this conviction that constitutes the methodological foundation of the present volume.

The inspiration for undertaking this research came from one of the foremost scholars and interpreters of the life and mission of Mother Teresa, Monsignor Lush Gjergji, who for decades has emphasized that the origins of her vocation cannot be fully understood without returning to the Catholic periodicals that followed her journey step by step. According to him, anyone seeking to penetrate the documentary history of Gonxhe Bojaxhiu must carefully examine the pages of "Katoličke Misije", the Catholic missionary journal published in Zagreb, for it is there that the earliest documentary evidence of her missionary calling has been preserved.

This recommendation was far more than a bibliographical suggestion; it became the point of departure for a new historiographical investigation.

The realization of this research would not have been possible without the invaluable support of the Ambassador of the Republic of Kosovo to the Republic of Croatia, Prof. Dr. Martin Berisha, whose institutional commitment made possible access to the National and University Library in Zagreb. Thanks to his dedicated assistance, it became possible to conduct a systematic examination of the complete collections of "Katoličke Misije", which preserve some of the earliest and most authentic documents concerning the beginning of Gonxhe Bojaxhiu's missionary journey.

Within those pages, one does not yet encounter the saint who would later be venerated throughout the world. Instead, one discovers a young Albanian woman from Skopje, leaving behind her family, her homeland, and everything she had ever known in order to respond to what she understood as the will of God. The journal follows, in chronological order, her departure for Ireland, her letters from Dublin, her arrival in India, her first experiences within the Institute of Loreto, her encounter with an unfamiliar culture, the challenges of missionary life, and her uninterrupted spiritual growth. Every letter, every photograph, and every report published while these events were taking place now constitutes an irreplaceable historical document of exceptional value.

Yet the research could not remain confined to Zagreb alone.

Investigations carried out in the libraries of Skopje brought to light another documentary corpus of equal importance: "Blagovest" (Blagovijest), the official periodical of the Diocese of Skopje–Prizren, founded in 1928 by Bishop Janez Gnidovec. If "Katoličke Misije" documents the birth and early development of Gonxhe Bojaxhiu's missionary vocation within the universal dimension of the Catholic Church, "Blagovest" preserves the local memory of the community in which that vocation first took shape. These two periodicals do not stand in opposition to one another; rather, they complement each other, forming together a unique documentary corpus without which Gonxhe Bojaxhiu's journey cannot be fully reconstructed.

History is often written after events have already concluded. Yet there are rare occasions when history is recorded simultaneously with the events themselves. Gonxhe Bojaxhiu's life belongs precisely to this exceptional cat-

egory. Her story was not constructed solely through retrospective memory; instead, it was documented step by step in the pages of these two Catholic periodicals, which became the silent chroniclers of a transformation that no one at the time could have foreseen.

When Bishop Janez Gnidovec founded "Blagovest" in 1928, no one could have imagined that its pages would become the earliest chronicle documenting the birth of a universal mission. The journal was originally intended to strengthen the spiritual life of the faithful of the Diocese of Skopje–Prizren, to promote priestly and religious vocations, and to maintain a living connection with Catholic missions throughout the world. History, however, entrusted it with a far greater mission: preserving the documentary memory of the Albanian girl from Skopje who would become Mother Teresa.

On the pages of "Blagovest", however, the image that first emerges is not that of the saint. Instead, we encounter Gonxhe the young woman spiritually formed within the Church of the Sacred Heart of Jesus, educated in the spirit of the Marian Congregation, and nourished by the testimonies of missionaries that the journal published on a regular basis. The letters arriving from India, Africa, and China were not merely ecclesiastical reports; they awakened among young readers the conviction that the Gospel knows no borders and that service to one's fellow human being represents the highest expression of Christian witness.

In this sense, "Katoličke Misije" and "Blagovest" were far more than periodicals reporting missionary activities. They became integral to Gonxhe's own spiritual formation. Through their pages she encountered the missionary world long before she would see it with her own eyes. The accounts of missionaries inspired within her the desire to serve the poorest of the poor and directed her vision toward a horizon extending far beyond the boundaries of the city in which she had been born.

It is therefore no coincidence that, immediately after setting out on her own missionary path, Gonxhe herself became a contributor to these very journals.

Her letters from Dublin, Darjeeling, and Calcutta were published almost immediately, creating an extraordinary relationship between reader and author. The young woman who had once found inspiration within the pages of these periodicals now inspired others through those same pages. This transi-

tion from reader to witness constitutes one of the most significant dimensions of her personal history and, at the same time, offers a remarkable example of how a missionary culture perpetuates and renews itself across generations.

In 1929, "Blagovest" published her first letter, written during her voyage to India. For the first time, the faithful of Skopje heard the voice of a young missionary who was recounting not merely a geographical journey, but the birth of an inner spiritual pilgrimage. Thereafter, the journal continued to publish her letters, reports, and testimonies, making it possible to follow chronologically the gradual unfolding of her spiritual development.

In December 1932, "Blagovest" presented Gonxhe Bojaxhiu alongside Sister Gabriela Anastazija Mihillit and Ana as three Albanian young women dedicated to missionary and religious life. This was not a retrospective tribute but a contemporary testimony demonstrating that the Catholic community of Skopje had already recognized the significance of their vocation and mission.

Throughout the years that followed, the journal continued to preserve the memory of this extraordinary journey. The letters from the Loreto Convent in Entally, the testimonies of Sister Gabriela Anastazija Mihillit, and the materials republished after the Second World War reveal the inner world of Sister Teresa: her unwavering dedication, sacrifice, silence, spiritual darkness, and the steadfast faith that accompanied her throughout her entire life.

When the world would later come to know the recipient of the Nobel Peace Prize, "Blagovest" had no need to introduce her. The journal had known her long before. It had witnessed the birth of her mission many years before the name Mother Teresa became known across the globe.

Herein lies the true historiographical significance of these two periodicals.

Within the methodology of contemporary historical scholarship, primary sources possess the highest evidentiary value because they do not reconstruct memory after the event; rather, they record it while history itself is unfolding. The documents published in "Katoličke Misije" and "Blagovest" are not later interpretations or retrospective narratives. They preserve the language of their own time, the emotional immediacy of lived experience, authentic chronology, and the credibility of direct witnesses. It is precisely these

qualities that make them indispensable primary sources for the modern historiography of Mother Teresa's life and mission.

At the same time, these journals illuminate the cultural, religious, and social environment in which her personality was formed. Mother Teresa's story does not begin in Calcutta. It begins in Skopje. It begins within the Bojaxhiu family. It begins in the Church of the Sacred Heart of Jesus, where Gonxhe was educated in the spirit of service, charity, and solidarity. It begins in the Marian Congregation, where her apostolic ideal was nurtured. And it begins within the pages of "Katoličke Misije" and "Blagovest", where, for the first time and in the language of their own era, the emergence of a vocation destined to become universal was documented.

This book was born from the conviction that these documentary materials should not remain dispersed throughout library collections or be known only to a limited circle of specialists. Its purpose is to bring them together into a single documentary corpus, thereby presenting, for the first time, a comprehensive chronological narrative of the transformation of Gonxhe Bojaxhiu into the universally recognized Mother Teresa.

As the year 2028 approaches the centenary of her departure for the missions the return to these primary sources acquires particular significance. It is far more than an exercise in historiography; it is an act of remembrance, scholarly responsibility, and cultural consciousness. Its purpose is to restore to the center of scholarly attention not only the figure of Mother Teresa herself, but also the spiritual, cultural, and ecclesiastical world from which her extraordinary vocation emerged.

Ultimately, this is the fundamental mission of the present volume.

Its purpose is to demonstrate that the history of Mother Teresa is not merely the history of a saint. It is the history of a vocation, of a faith community, of a spiritual culture, and of an identity which, beginning in Skopje, ultimately touched the conscience of humanity.

For this very reason, "Katoličke Misije" and "Blagovest" should not be regarded simply as two Catholic periodicals within the history of the Church in the Balkans. They are, rather, two complementary witnesses to the birth of a universal mission. One documented, in real time, the emergence of a missionary vocation; the other preserved its memory, continuity, and identity across subsequent decades. Together, they constitute a unique documentary

corpus without which the transformation of Gonxhe Bojaxhiu into the universal Mother Teresa cannot be fully understood in its historical, academic, spiritual, and cultural dimensions.

Beyond their documentary significance, these periodicals reveal another essential truth: the universal mission of Mother Teresa did not emerge suddenly, nor was it the product of later recognition. It was patiently formed within the spiritual life of the Catholic community of Skopje, nurtured by the missionary consciousness cultivated by the Church, strengthened through personal sacrifice, and faithfully recorded by contemporary witnesses. The pages of these journals preserve the living memory of a vocation while it was still unfolding, allowing today's historian to reconstruct not only the sequence of events but also the spiritual atmosphere in which they occurred.

Consequently, the value of these sources extends well beyond the biography of a single individual. They illuminate an entire historical context, demonstrating how a local ecclesial community, through its educational, pastoral, and missionary institutions, contributed to the formation of a personality whose influence would eventually transcend national, cultural, and religious boundaries. In this respect, the documentary heritage preserved in "Katoličke Misije" and "Blagovest" represents not only an indispensable contribution to Mother Teresa studies but also an important chapter in the religious, cultural, and social history of Southeast Europe.

The pages that follow therefore invite the reader to undertake a journey through authentic documents rather than retrospective narratives. They offer an opportunity to encounter Gonxhe Bojaxhiu before the world came to know her as Mother Teresa to follow, step by step, the gradual unfolding of a vocation that would ultimately become one of the most extraordinary humanitarian and spiritual missions of the twentieth century.

The intention of this volume is neither to construct a new legend nor merely to recount an already familiar biography. Its ambition is to restore the historical voice of the original sources, allowing contemporary documents to speak for themselves. Through letters, photographs, reports, missionary chronicles, and ecclesiastical records, the reader is invited to witness the gradual emergence of a life wholly dedicated to God and to humanity.

In this sense, the present work aspires to serve not only historians and theologians but also scholars of culture, religion, and humanitarian studies,

as well as every reader seeking to understand how a vocation born within the modest surroundings of Skopje came to assume universal significance. It is an invitation to rediscover the enduring value of documentary evidence, for only primary sources preserve history in its original integrity and reveal the profound human and spiritual dimensions that later narratives often overlook.

This, therefore, is the mission of this book. And this is the invitation it extends to every reader: to return to the sources, for it is only through the sources that the authentic truth of history remains preserved, allowing us to understand how the journey of a young Albanian woman from Skopje became one of the greatest humanitarian and spiritual testimonies of modern civilization.

The Authors

KAPITULLI I PARË

I. Lindja e një ndërgjegjeje universale

Historia e qytetërimeve dëshmon se personalitetet që arrijnë të ndryshojnë ndërgjegjen morale të njerëzimit nuk lindin në çastin kur bota fillon t'i njohë, por shumë më herët, në heshtjen e familjes, në kulturën e bashkësisë ku janë rritur dhe në përvojat e para që formësojnë mënyrën e tyre të të menduarit. Për këtë arsye, historia e Gonxhe Bojaxhiut nuk mund të fillojë në Kalkutë, as në ditën kur ajo mori Çmimin Nobel për Paqe, e aq më pak në çastin e shenjtërimit të saj. Ajo fillon në Shkupin e viteve njëzet, në një bashkësi të vogël katolike shqiptare, ku besimi nuk ishte vetëm praktikë liturgjike, por mënyrë jetese, ku familja nuk përfaqësonte vetëm një institucion shoqëror, por shkollën e parë të përgjegjësisë ndaj njeriut, dhe ku ndjenja e solidaritetit ndërtohej si pjesë e pandashme e identitetit njerëzor. Pikërisht në këtë hapësirë historike fillon rrugëtimi i një vajze që dokumentet e kohës e njohin vetëm si Gonxhe Bojaxhiu, pa e ditur se po regjistronin hapat e parë të një figure që do të bëhej simbol universal i mëshirës dhe dinjitetit njerëzor.[1]

Në këtë kuptim, Shkupi nuk duhet parë vetëm si vendlindja e Gonxhes, por si hapësira historike ku u formua një kulturë shpirtërore me aftësinë për të prodhuar personalitete që e kuptonin jetën si shërbim. Bashkësia katolike shqiptare, ndonëse numerikisht e vogël, kishte krijuar një traditë të qëndrueshme edukimi fetar, kulturor dhe qytetar. Kisha e Zemrës së Krishtit nuk ishte vetëm vendi ku kremtohej liturgjia, por qendra rreth së cilës organizohej

[1] *"Katoličke Misije"*, Viti III, nr. 10, Zagreb, dhjetor 1928; "Blagovijest", dhjetor 1932.

jeta e komunitetit, edukimi i të rinjve, veprimtaria bamirëse dhe formimi moral i brezit të ri. Pikërisht këtu, në atmosferën e Kongregatës Mariane, të korit kishtar dhe të shoqatave të vajzave katolike, Gonxhja mësoi se besimi nuk përfundon me lutjen, por vazhdon në përgjegjësinë konkrete ndaj tjetrit. Kjo kulturë e shërbimit nuk ishte produkt i një ideje abstrakte, por pjesë e jetës së përditshme të familjeve shqiptare katolike të Shkupit, të cilat e konsideronin bamirësinë dhe solidaritetin si shprehje të natyrshme të besimit të tyre.[2]

Burimet dokumentare e paraqesin Gonxhen si një nga nxënëset më të dalluara të gjimnazit të Shkupit. Ajo gëzonte respektin e mësuesve dhe të bashkëmoshatarëve jo vetëm për aftësitë e saj intelektuale, por edhe për seriozitetin, disiplinën dhe angazhimin në jetën e bashkësisë kishtare. Ishte pjesëmarrëse e rregullt në korin e kishës, një nga figurat më aktive të Kongregatës Mariane dhe shpirti i shoqatave katolike të vajzave. Kjo dëshmi është me rëndësi të jashtëzakonshme historiografike, sepse tregon se thirrja e saj misionare nuk lindi si shkëputje nga jeta që bënte, por si vazhdimësi logjike e një edukimi të ndërtuar mbi përgjegjësinë, disiplinën dhe dashurinë ndaj njeriut. Pikërisht për këtë arsye, dokumentet nuk e paraqesin vendimin e saj si një impuls të papritur emocional, por si përfundimin natyror të një procesi të gjatë formimi moral dhe shpirtëror.[3]

Në një nga dëshmitë më domethënëse të botuara në "Katoličke Misije", thuhet se thirrja e Hyjit e gjeti Gonxhen ndërsa ishte ende në klasën e gjashtë të gjimnazit. Autorët e revistës e krahasojnë këtë moment me thirrjen apostolike të Shën Pjetrit, i cili la rrjetat për të ndjekur Krishtin. Krahasimi nuk ka karakter retorik të rastësishëm; ai përfaqëson mënyrën se si bashkëkohësit e kuptonin vendimin e saj. Ashtu si Pjetri la mjetin e jetës së tij, edhe Gonxhja la librat, rininë dhe sigurinë e jetës pranë familjes për t'iu përgjigjur një thirrjeje që nuk premtonte as lavdi, as siguri, por vetëm shërbim. Kjo analogji biblike zbulon mënyrën se si komuniteti e interpretonte zgjedhjen e saj: jo si humbje, por si dorëzim të vetëdijshëm në shërbim të Hyjit dhe të njerëzimit.[4]

Ky vendim nuk preku vetëm familjen Bojaxhiu. Ai u përjetua si ngjarje e gjithë bashkësisë katolike shqiptare të Shkupit. Burimet tregojnë se largimi i saj krijoi një boshllëk të ndjeshëm në jetën e komunitetit, sepse Gonxhja ishte

[2] *"Blagovijest"*, dhjetor 1932; *"Katoličke Misije"*, Viti III, nr. 10, Zagreb, dhjetor 1928.

[3] *"Katoličke Misije"*, Viti III, nr. 10, Zagreb, dhjetor 1928.

[4] *"Katoličke Misije"*, Viti III, nr. 10, Zagreb, dhjetor 1928.

bërë pjesë e pandashme e veprimtarive rinore dhe kishtare. Kjo dëshmi ka rëndësi të veçantë, sepse tregon se identiteti i saj ishte ndërtuar gjithmonë në marrëdhënie me komunitetin. Ajo nuk u formua në vetmi, por në një mjedis ku besimi ishte përvojë kolektive dhe ku edukimi moral ndërtohej në bashkëpunim ndërmjet familjes, Kishës dhe jetës shoqërore. Kjo është arsyeja pse historia e saj nuk mund të reduktohet në biografinë e një individi; ajo duhet të lexohet si histori e një bashkësie që arriti të krijojë kushtet për lindjen e një ndërgjegjeje universale.[5]

Në këtë panoramë historike shfaqet edhe figura e Nasta Mihillit, e cila, së bashku me Gonxhen dhe Anën, përfaqësonte të njëjtin brez vajzash shqiptare të formuara në atmosferën shpirtërore të Shkupit. Përmendja e tyre së bashku në faqet e "Blagovest" nuk është rastësore. Ajo dëshmon se bashkësia katolike shqiptare nuk prodhoi vetëm një misionare të jashtëzakonshme, por një kulturë të tërë misionare. Nasta Mihilli nuk duhet parë si figurë dytësore në këtë histori. Përkundrazi, prania e saj forcon tezën se misioni nuk ishte një përvojë individuale e Gonxhes, por pjesë e një vetëdijeje kolektive të brezit të ri katolik shqiptar. Kjo është arsyeja pse analiza historiografike nuk duhet të kufizohet vetëm në figurën e Nënë Terezës, por duhet të përfshijë edhe ato gra që, edhe pse mbetën jashtë vëmendjes së historiografisë ndërkombëtare, përbënin pjesë të së njëjtës kulturë shpirtërore që e bëri të mundur lindjen e saj. [6]

Rruga që u hap para Gonxhe Bojaxhiut në fund të verës së vitit 1928 nuk ishte thjesht një largim fizik nga qyteti i lindjes, por fillimi i një procesi historik, të cilin bashkëkohësit nuk mund ta parashikonin në përmasat që do të merrte më vonë. Pikërisht këtu qëndron një nga veçoritë më të rëndësishme të korpusit dokumentar të "Katoličke Misije". Revista nuk shkruan për një figurë që tashmë kishte hyrë në histori, por për një vajzë shqiptare që po largohej drejt një bote të panjohur, e udhëhequr vetëm nga bindja se po i përgjigjej thirrjes së Hyjit. Ky realizëm dokumentar përbën një nga vlerat më të mëdha historiografike të burimit, sepse ai regjistron ngjarjen në çastin kur ndodh, pa e ngarkuar me kuptimet që ajo do të fitonte shumë dekada më vonë. Për studiuesin e sotëm, pikërisht kjo mungesë e perspektivës retrospektive e bën dokumentin jashtëzakonisht të besueshëm, pasi lejon të rindërtohet his-

[5] *"Katoličke Misije"*, Viti III, nr. 10, Zagreb, dhjetor 1928; *"Blagovijest"*, dhjetor 1932.

[6] *"Blagovest"*, dhjetor 1932; *"Blagovest"*, nr. 9, 1974.

toria sipas ritmit të saj natyror dhe jo sipas njohurive të fituara më vonë.[7]

Možda mnogima nije poznato da je tu veliku dušu duhovno oblikovao i pomogao joj poći u misije naš hrvatski isusovac, danas već pok. o. Franjo Jambreković. On je djelovao u Skoplju u Isusovačkoj rezidenciji uz koju se nalazila i župa. Mlada Gonđa Bojadžu nikada nije zaboravila svoga duhovnog vođu. I kasnije mu je povremeno pisala pisma puna neposrednosti u kojima je otkrivala svoju dušu. Ovdje iznosimo jedno pismo što ga je pisala svom bivšem duhovnom vođi prije zadnjih zavjeta, i drugo što ga je pisala poslije zavjeta.

Prvo pismo

Loreto Convent, Entally,
8. februara 1937.

U Isusu dragi Oče!

Srdačna Vam hvala na Vašem listu. Nisam zaista očekivala. Oprostite da Vam nisam prije pisala.

Upravo sam dobila list od Č. Majke Generalice gdje mi daje dozvolu da položim svoje vječne zavjete. To će biti 24. svibnja 1937. Kakva velika milost! Zaista ne mogu se dosta zahvaliti Bogu za sve što je On učinio za me. Njegova za vječnost! Sada se iz srca veselim da sam veselo svoj križ nosila sa Isusom. Bilo je trpljenja, bilo je časova kad su mi oči bile pune suza. Ali hvala Bogu za sve! Isus i ja bili smo prijatelji do sada. Molite se da mi On da milost ustrajnosti.

Ovog mjeseca počinjem svoju tromjesečnu treću probaciju. Bit će tamo dosta i puno toga za Isusa i duše, ali tako sam sretna. Prije su me križevi strašili koža mi se ježila pri pomisli na trpljenje, ali sada zagrlim trpljenje prije ne-



Majka Terezija

go je zaista došlo, i tako Isus i ja živimo u ljubavi.

Nemojte misliti da je moj duhovni život prostrt ružama. To cvijeće skoro nikad ne nalazim na svom putu. Dapače, više imam kao drugaricu tamu. Pa kad noć postane jako gusta i sve mi izgleda kao da ću svršiti u paklu, onda jednostavno prikažem sebe Isusu: ako On hoće da ja odem tamo, spremna sam, samo pod jednim uslovom, da to zaista Njega veseli.

Treba mi mnogo milosti, mnogo Kristove jakosti da ustrajem u pouzdanju, u onoj slijepoj ljubavi, koja vodi samo k Isusu Raspetom. Ali ja sam sretna — da, sretinja nego ikada, i ne bih željela ni pod koju cijenu da dam svoja trpljenja.

Ipak nemojte misliti da ja zaista samo trpim, Oh ne! Smijem se ja više negoli trpim, tako da su neki zaključili da sam razmažena Isusova zaručnica koja živi uz Isusa u Nazaretu- daleko od Kalvarije. Kad se moji Indijci smiju, onda se ja još slađe nasmijem.

Molite se, molite se puno za me! Zaista trebam Njegovu ljubav!

Oprostite, što sam se toliko raspričala, ali ne znam ni ja sama kako. Isus je sigurno ovo želio, da Vas potakne da se malo više molite za Vašu misionarku.

Sestra Marija Gabrijela je ovdje. Radi u St. Mary's. Vidimo se svaki dan. Ja je poučavam u bengalskom, a onda i u St. Mary's smo zajedno ujutro i navečer, jer preko dana idem ja sa četiri bengalske sestre u St. Teresa's. Ona je jako sretna i vesela ovdje. Poučava u školi. Uvijek je spremna da mi pomogne.

Sestra Bernarda upravo je otišla natrag u novicijat. Bila je ovdje šest mjeseci. Ona će položiti svoje svete zavjete, ako Bog da, početkom godine 1938. Trpjela je mnogo, ali sada je sve u redu. Dragi Bog je sigurno mnogo ljubi, kad joj je dao ovakav veliki križ.

Mama piše veoma redovno. Zaista ona mi daje snage da veselo trpim. Moj odlazak bio je zaista početak njenog svrhunavranog života. Kada ona ode k Isusu sigurno će je On primiti s velikim veseljem. Brat i sestra još su zajedno. Imaju zajedno lijep život.

Vi ste sigurno jako zaposleni, a da mislite na pisma, ali jedno Vas molim: molite se uvijek za me!

Neki dan sam se slatko smijala, kad su mi neki događaji iz Letnice došli na pamet. Zaista, kako sam ja tada bila ohola — nisam ni sada ponizna, ali ipak želim da to postanem. Poniženja su mi najsladi slatkiši. Kako ste Vi bili strpljivi! Zaista to me čudi i pomaže da i ja budem strpljiva sa svojim Indijcima.

Moram ići. Indija je vruća kao pakao, ali njene duše su lijepe i skupocjene, jer ih je Kristova Krv orosila.

Srdačno Vas pozdravlja i moli za blagoslov i molitve

Vaša u Isusu

Sestra M. Terezija, IBM

403

Drugo pismo

Loreto Convent, Entally, 25. nov. 1937.

U Isusu dragi Oče!

Božićni se praznici približavaju. Dok ovo pismo stigne do Vas, mi ćemo svi uživati radost Malog Isusa. Zato Vam šaljem svoje srdačne čestitke. Dao dragi Bog da puno učinite za Njega i duše. Molite isto i za Vašu misionarku!

Sigurno znate da sam položila svoje vječne zavjete. Mislia sam i na Vas toga dana. Da znate kako sam bila sretna, što sam svojovoljno mogla zapaliti svoju žrtvu. Njegova sam, i to zauvijek! Vi si sigurno ne možete predstaviti nekadašnju Gonđu sada kao Isusovu zaručnicu. Ali On je uvijek bio tako neizmjerno dobar prema meni, kao da je htio da osigura imutak moga srca za sebe. Opet Vam iskreno zahvaljujem za sve što ste za me učinili!

S. Gabrijela je ovdje i lijepo radi za Isusa. Glavno je da zna trpjeti i usto se smijati.

Pomaže mi mnogo u mnogim stvarima, inače bih sama sigurno negdje pala. Uvijek je spremna da mi pomaže, a ja sam tako zločesta da izrabljujem njenu dobrotu.

S. Bernarda polaže zavjete 23. 1. 38. Hvala Bogu, sada je opet sve dobro! Isus je sigurno odabrao nju za nešto posebno, kad joj daje toliko trpljenja. A ona je prava junakinja, pa sve podnosi hrabro sa smiješkom.

Jadni Otac Mesarić izgubio je parnicu. Hvala Bogu za sve! Otac podnosi sve tako velikodušno te sam sigurna da će plod biti stostruk, iako na prvi pogled izgleda da je izgubio. Ako hoćemo Bengaliju za Krista, imamo platiti mnogim žrtvama. Sad se zaista veselim kad nešto ne ide kako ja želim, jer vidim On hoće naše pouzdanje. Zato u gubitku hvalimo Boga kao da smo sve dobili.

Možda Vam je mama pisala. Ona je sada kod brata. Tako su sretni. Jedna im samo manjka, a to je njihova Gonđa. Ali, hvala Bogu, mama ima sada opet blizu crkvu i može govoriti albanski koliko joj drago. Sestra je postala prefekta Marijine Kongregacije za gimnazijalke. Nadam se da će mnogo učiniti za Isusa.

Sigurno želite malo novosti o meni. Jedno Vas molim: molite mnogo za mene! Trebam molitve više nego ikada. Želim biti samo Isusova, i to stvarno, a ne samo po imenu i odijelu. Više puta ide to natraške, pa moj uzvišeni »Jak« dobije glavno mjesto. Uvijek ista, ohola Gonđa. Samo jedno je sad drukčije: moja ljubav prema Isusu. Dala bih sve, pa i sam život za Njega. Zvuči lijepo, ali u praksi nije tako lako, a to baš ja hoću da ne bude lako.

Sjećate li se, Vi ste mi jednom rekli u Skoplju: »Gonđa, Ti želiš ispiti kalež do zadnje kapi!« Ne znam da li sam tada ovako mislila, ali sada mislim, i to veselo, bez jedne suze.

Sigurno će naše misionarke biti već na putu kad Vi dobijete ovo pismo. Radujem se njihovu dolasku i zaista brojim dane. Trebamo tako mnogo radnica, a nas je tako malo. Pomislite, ja imam 375 djece. Sama sam bjelkinja medu njima. U ovoj školi moram i poučavati. Ne ide to tako lako kad čovjek mora biti na nogama od jutra do večeri, ali ipak sve za Isusa, pa tako je sve lijepo ako i jest teško.

Strašno sam pospana večeras, stoga mi oprostite što sam ovako pisala, ali ako večeras ne svršim, sutra će biti prekasno.

Molite puno za me!

Uvijek u Isusu odana

M. Terezija, IBM

Iz pisma sestre Gabrijele

Susestra sestre Terezije sestra Gabrijela istom je ocu Jambrekoviću napisala pismo u kojem među ostalim piše:

»Mislim da sestru Terezu Isus jako ljubi. Mi se nalazimo u istoj kući. Opažam svaki dan kako ona nastoji da Isusu u svemu ugodi. Ima puno posla, ali ona ne žali sebe. Veoma je ponizna. To ju je puno stajalo da to postigne, ali ja mislim da ju je dobri Bog odabrao za velike stvari . . .«

22 GODINE KASNIJE:

Godine 1959. pohodio je već tada poznatu Misionarku Ljubavi, Majku Tereziju slovenski misionar u Bengaliji, otac Alojzije Demšar. O tom susretu piše:

»Kad sam došao u dispanzer u Titaghuru, vidio sam duge redove gubavaca, koji su se gurali pred stolom, gdje ih je jedna sestra upisivala. Zatim su ižli k liječniku, koji bi im izvadio krv iz uha ili ruke, te je analizirao, da li je guba izlječiva i kakvog je tipa, da li je zarazna ili ne . . . Majka Terezija bila je najprije zaposlena nacrtom novog dispanzera, a onda je sama prišla i pregledavala bolesnike.

Vidio sam male djevojčice od jedva dvije godine, koje su već imale vidljive znakove te strašne bolesti. Majka ih je Terezija tako nježno primala i davala im lijekove, da me je to ganulo. Primila je za ruku mladu ženu, koja je imala velike otvorene rane na nogama, na čelu . . . Majka Terezija mi je rekla da je to veoma opasan, priljepčiv tip gube, a ona je tu ženu primila za ruku, dala joj injekciju, kao da ništa nije bilo. Groza me uhvatila kad sam vidio kako s njima prijazno postupa, daje im masti na rane, vadi im krv za ispitivanje, daje injekcije, pogladi nedužnu djecu po glavi, a sve to bez ikakvog straha. Pitam je: 'Ne bojite li se da i Vi dobijete ovu bolest?' Ona mi je odgovorila: 'Što zato! Nije li Isus ljubio gubavce, koje svi napuštaju i preziru? On ih je sam ozdravljao i nije dobio gubu . . . Ako ja dobijem, neka se vrši Božja volja, bit će to kao cijeli moj život žrtva ljubavi za Njega!'

Nakon toga razgovora poslala mi je sutradan pisamce, koje je napisala hrvatskim jezikom:

»U Isusu dragi Oče!

Drago mi je što ste došli u Titaghur, no izgledali ste tako umorni i nešto žalosni. Vaša veselost za mene je uvijek kao tonikum. No danas nije bilo tako. Vi ste me pitali: Što, ako ja dobijem tu bolest? To će biti moj zadnji »Fiat« dragom Bogu. Sve je uzeo, pa i moje tijelo može uzeti potpuno. Prije sam se strašno bojala gube i gubavaca. Strah je još u srcu, ali dragom Bogu sam sve prikazala, pa se često smiješim, jer hoću da i pred Njim sakrijem svoje osjećaje i da dadem veselu žrtvu. Ovo je za Vas da se molite za mene da budem vesela sve do kraja. Hvala Bogu, On mi je dao milost veselja, pa nitko, niti moje sestre ne mogu vidjeti što drugo. Molite se za me, kao što se i ja molim za Vas da postanemo žrtva paljenica Njegove ljubavi.

U Isusu odana

Majka Terezija, M. C.«

Treba li ovim pismima tumačenja? Mislim da ne treba. Ali možda nam ona najbolje pokazuju kakve duše Bog danas traži za obnovu svijeta. I misionari samo će toliko uspjeti koliko se savršenije sami predaju Bogu kao žrtve paljenice zaboravljajući sami sebe. Molimo mnogo za takve misionare i misionarke. A ujedno zahvalimo dragom Bogu što je ovdje među nama našao i odgojio tu veliku dušu — Majku Tereziju.

—o—

Ovaj puta o drugim našim misionarima ne možemo donijeti vijesti zbog pomanjkanja prostora. Učinit ćemo to u narednom broju Glasnika. Samo dodajemo, da se svi naši misionari i u Bengaliji i u Zambiji i u Zaire zahvaljuju na molitvama, žrtvama i materijalnoj pomoći što su ih prinijeli za njih prijatelji misija. Sve prijatelje misija pozdravljaju: o. Ante Gabrić iz Basantija, o. Stjepan Polgar iz Morapaja, o. Julije Pogany iz Mpime u Zambiji, č. br. Ilija Dilber i č. br. Benedikt Fostač iz Lusake, te č. sestra Anka Luketić iz Zaire, s. Emica iz Litete u Zambiji, č. sestra. Silvina i Emerika u Indiji. Ne zaboravite ih u svojim molitvama.

APOSTOLAT MOLITVE

Apostolat molitve živi i djeluje i u ovom našem sekulariziranom svijetu koji pokazuje sve manje smisla za religiozne vrednote. U takvom ozračju njegova je zadaća još kudikamo važnija nego da su prilike za razvoj religioznosti, osobito kršćanske, povoljne. I dok mnogi u kršćanskom taboru upadaju u neku u mornost, malodušnost ili čak uvjerenje da se danas ne može ništa postići, dotle svjesni članovi Apostolata molitve rade uporno i sa živom vjerom u svoje apostolsko poslanje. I današnjem čovjeku valja pomoći da u sebi razvije kršćansku religioznu dimenziju. Tomu veoma mnogo pomaže duhovni program Apostolata molitve, koji je bez mnogo muke i mudrovanja ostvariv za svakoga. Pogledajmo što čine apostoli molitve u S A D i na Filipinima?

SJEDINJENE AMERIČKE DRŽAVE — Pokrajinski upravitelj A M u državi New-York o. Mc Bride započeo je s upriličivanjem duhovne obnove u župama gdje postoji središnjica Apostolata molitve, po kojoj se promicatelji A M uvode sve više u njegovu duhovnost. Program duhovne obnove kratko je sadržan u lozinkama: »Jedan dan u samoći s Kristom«, »Kršćanski živjeti po Apostolatu molitve«. Vlastito je za te dane da na njima govore lajici i to o pet točaka duhovnog programa A M. (Taj program imamo tiskan i na hrvatskom jeziku na vrlo ukusnim sličicama Srca Isusova.) Nakon predavanja održavaju se ne samo diskusije već se sve skupa nadopunjuju zajedničkim čitanjem Svetog pisma, kratkim razmatranjima, molitvama i pjesmama.

Takav način promicanja programa i duhovnosti A M pokazao se vrlo uspješan, jer laici govore iz svog svakidašnjeg iskustva te iznose kakvu su pomoć i sami primili od prakticiranja A M. Iznošenje osobnog duhovnog iskustva uvijek je velika korist za druge, jer se time samo obogaćuju i nadahnjuju u svome apostolskome radu.

U župi u kojoj je živa pobožnost Srcu Isusovu, u kojoj su posvećenost crkve i primanje sakramenata živi osobito na prvi petak i prvu nedjelju, dušobrižnici bi mogli i kod nas upriličiti sastanak članova A M, poučavat ih u ostvarivanju njegova programa, da nakon toga na narednim sastancima i sami vjernici iznose svoja duhovna iskustva potičući jedni druge na apostolat. Te grupe mogle bi postati živ kvasac župne zajednice pomažući tako njezinu duhovnom napretku pod zaštitom Srca Isusova.

RECENSION

RIKTHIMI TE BURIMET - RIKTHIMI TE E VËRTETA E THIRRJES

Mbi librin: *"Udha misionare e Gonxhe Bojaxhiut drejt Nënë Terezës universale ("Katoličke Misije" dhe "Blagovest")"*

Don Lush GJERGJI

Ka libra që rrëfejnë histori dhe ka libra që i rikthejnë historisë zërin e saj të parë. Libri i Prof. Dr. Skender Asanit dhe Dr. Albert Ramajt: Udha misionare e *Gonxhe Bojaxhiut drejt Nënë Terezës universal ("Katoličke Misije" dhe "Blagovest")*, i përket kësaj kategorie të veprave që nuk kufizohen në paraqitjen e fakteve, por rikthejnë në dritë burimet autentike mbi të cilat ndërtohet e vërteta historike. Nuk kemi të bëjmë vetëm me një botim dokumentesh, por me një studim të mirëfilltë shkencor, të mbështetur mbi kërkimin historiografik, analizën kritike dhe interpretimin human e shpirtëror të dy revistave katolike më të rëndësishme të kohës, Katoličke Misije dhe Blagovest, të cilat u bënë kronistet e para të rrugëtimit të Gonxhe Bojaxhiut shumë kohë përpara se bota ta njihte si Nënë Terezën. Vlera e kësaj vepre qëndron në faktin se ajo e rikthen lexuesin te burimet e kohës, aty ku Gonxhja ende nuk ishte shenjtorja e njerëzimit, por një vajzë shqiptare e Shkupit që kërkonte me gjithë zemër vullnetin e Hyjit dhe përgatitej t'i përgjigjej thirrjes së Tij.

Prej shumë vitesh kam qenë i bindur se, për ta kuptuar në mënyrë të plotë itinerarin e rrugëtimit të Gonxhe Bojaxhiut nga Shkupi drejt misionit, nuk mjaftonin vetëm kujtimet e mëvonshme apo biografitë retrospektive. Pikërisht për këtë arsye, i pata sugjeruar historianit Prof. Dr. Skender Asani që të hulumtonte, të sistemonte dhe t'i botonte artikujt e revistave Katoličke Misije dhe Blagovest, sepse aty ruhen dëshmitë më autentike mbi lindjen dhe zhvillimin e thirrjes së saj misionare. Sot, duke e parë këtë libër në prag të botimit, mund të them me bindje se ky vizion është realizuar në mënyrë të shkëlqyer. Kërkimi është zhvilluar me përpikëri shkencore, me besnikëri ndaj burimeve dhe me një ndjeshmëri të veçantë ndaj dimensionit shpirtëror që përshkon çdo dokument të kësaj periudhe.

Ky libër dëshmon bindshëm se Katoličke Misije dhe Blagovest nuk ishin vetëm dy revista informative të jetës kishtare. Ato ishin dy shkolla të vërteta të formimit misionar, të cilat ushqyen ndërgjegjen e brezit të ri me idealin e dhurimit të jetës për Krishtin dhe për më të varfrit e botës. Pikërisht në faqet e tyre Gonxhe Bojaxhiu u njoh me dëshmitë e misionarëve, me vuajtjet e popujve të largët dhe me idealin e shërbimit apostolik, që do të piqej më vonë në vendimin e saj për t'u bërë motër misionare. Prandaj, merita më e madhe e kësaj vepre është se dëshmon me argumente dokumentare se këto dy revista nuk ishin vetëm burime informacioni për misionet, por edhe pjesë përbërëse e formimit shpirtëror të Gonxhes. Më vonë, ato u bënë edhe vendi ku u botuan letrat e saj nga Dublini dhe India, duke krijuar një vazhdimësi të rrallë ndërmjet lexueses që frymëzohej nga këto faqe dhe misionares që, me dëshminë e jetës së saj, do të frymëzonte breza të tërë.

Kam pohuar shpesh se Gonxhe Bojaxhiu, për gjashtë vjet me radhë, ishte shtegtare besnike e Zojës së Letnicës. Ajo shkonte atje për dy arsye që e shoqëruan gjithë jetën. Arsyeja e parë ishte shëndetësore, sepse vuante nga malaria dhe vetëm në klimën e Letnicës merrte frymë më lirshëm, si me mushkëri, ashtu edhe me shpirt. Arsyeja e dytë ishte shumë më e thellë: kërkimi i thirrjes së saj. Para trupores së Zojës ajo lutej me pyetjen që e shoqëroi gjatë gjithë rinisë së saj: „Ti ma ke dhuruar jetën; unë çfarë të bëj me jetën time?" Kjo nuk ishte pyetja e një vajze të zakonshme, por lutja e një zemre që kërkonte vetëm vullnetin e Hyjit.

Natën e 14 gushtit 1928, në vigjiljen e festës së Zojës së Letnicës, Gonxhja ndezi një qiri dhe, e gjunjëzuar para trupores së Zojës, mori vendimin që do

ta ndryshonte jo vetëm jetën e saj, por edhe historinë e dashurisë së krishterë në shekullin XX: „Dua të bëhem motër misionare për t'u shërbyer dhe për t'i ndihmuar të varfrit e botës." Ky ishte çasti kur thirrja e saj u bë vendim. Lajmin e këtij vendimi ajo ia besoi fillimisht kushëririt të saj Lorenc Antoni, ndërsa më pas edhe hallës sime, Mrika Gjergji, e cila e ruajti këtë dëshmi si një kujtim të shenjtë. Pikërisht këtu bashkohen përvoja shpirtërore e Letnicës dhe dëshmia historike që ky libër sjell me aq kujdes: vendimi i Gonxhes nuk lindi në një çast të izoluar, por u ushqye për vite me radhë nga lutja, nga jeta kishtare, nga Kongregata Mariane dhe nga kultura misionare që përçohej në faqet e Katoličke Misije dhe Blagovest.

Nga pikëpamja historiografike, kjo vepër përfaqëson një kontribut të ri dhe të rëndësishëm në studimet mbi Nënë Terezën. Autorët nuk ndërtojnë interpretime mbi legjenda, por mbi dokumente; nuk e lexojnë jetën e saj nga fundi drejt fillimit, por nga fillimi drejt përmbushjes së saj. Pikërisht kjo është rruga e kërkimit të mirëfilltë shkencor. Burimet nuk përdoren për të mbështetur një tezë të parapërgatitur, por janë vetë ato që ndërtojnë tezën historike. Për këtë arsye, libri nuk është vetëm një përmbledhje dokumentesh, por një model metodologjik i historiografisë bashkëkohore, ku historia rindërtohet mbi dëshminë autentike të kohës.

Vlera më e madhe e kësaj vepre qëndron në faktin se ajo nuk na tregon vetëm çfarë bëri Nënë Tereza, por mbi të gjitha na ndihmon të kuptojmë si u bë ajo Nënë Terezë. Midis vajzës shqiptare që largohet nga stacioni hekurudhor i Shkupit në vitin 1928 dhe shenjtores që më vonë do të prekte ndërgjegjen e mbarë botës, ekziston një urë e padukshme. Kjo urë ndërtohet nga familja Bojaxhiu, nga Kisha e Zemrës së Krishtit, nga Kongregata Mariane, nga Zoja e Letnicës dhe nga kultura misionare që ushqyen faqet e Katoličke Misije dhe Blagovest. Pikërisht këtë urë autorët kanë arritur ta rindërtojnë me kompetencë shkencore dhe me ndjeshmëri të admirueshme shpirtërore.

Në këtë kuptim, nuk kemi përpara vetëm një botim dokumentesh, por një akt të rëndësishëm të kujtesës kishtare, kombëtare dhe shkencore. Kjo vepër i rikthen historisë zërin e saj origjinal dhe dëshmon se Nënë Tereza nuk lindi rastësisht. Ajo u formua në një mjedis të pasur shpirtëror, në një familje me besim të gjallë, në një bashkësi që jetonte Ungjillin dhe në një kulturë misionare që ushqente idealin e dhurimit të jetës për të tjerët.

Jam i bindur se ky libër do të zërë një vend të rëndësishëm në bibliografinë ndërkombëtare kushtuar Nënë Terezës. Ai do t'u shërbejë historianëve, teologëve, studiuesve të misioneve, por edhe çdo lexuesi që dëshiron të njohë të vërtetën dokumentare të rrugëtimit të Gonxhe Bojaxhiut. Është një vepër që i rikthen dinjitetin burimeve historike, pasuron historiografinë shqiptare dhe njëkohësisht i jep Kishës një kontribut të çmuar në ruajtjen e kujtesës së saj.

Prandaj, me kënaqësi dhe bindje të plotë e përshëndes botimin e kësaj vepre dhe e rekomandoj si një studim referencial për të gjithë ata që dëshirojnë ta njohin fillesën e vërtetë të rrugëtimit misionar të Gonxhe Bojaxhiut. Duke u kthyer te burimet autentike, autorët dëshmojnë se historia e Nënë Terezës nuk fillon në Kalkutë, por në Shkup, në Letnicë, në faqet e Katoličke Misije dhe Blagovest, aty ku u mboll fara e një thirrjeje që do të shndërrohej në një mision universal të dashurisë, mëshirës dhe shërbimit ndaj mbarë njerëzimit.

Letnicë, 6 gusht 2026

РЕЦЕНЗИЈА

ВРАЌАЊЕ КОН ИЗВОРИТЕ - ВРАЌАЊЕ КОН ВИСТИНАТА НА ПОВИКОТ

За книгата: *Мисионерскиот пат на Гонџе Бојаџиу кон универзалната Мајка Тереза („Katoličke Misije“ и „Blagovest“)*

Дон Луш ЃЕРЃИ

Постојат книги што раскажуваат историја, а постојат и книги што ѝ го враќаат на историјата нејзиниот првобитен глас. Книгата на проф. Д-р Скендер Асани и Алберт Рамај: „Katoličke Misije“ и „Blagovest“: Документирањето на преобразбата на Гонџе Бојаџиу во универзалната Мајка Тереза, припаѓа токму на оваа категорија дела, кои не се ограничуваат само на презентирање на историските факти, туку повторно ги изнесуваат на светлина автентичните извори врз кои се темели историската вистина.

Овде не станува збор само за објавување на документи, туку за вистинска научна студија, заснована врз сериозно историографско истражување, критичка анализа и длабока хумана и духовна интерпретација на двете најзначајни католички списанија на своето време – Katoličke Misije и Blagovest, кои станаа првите хроничари на животниот и мисионерски пат на Гонџе Бојаџиу, многу пред светот да ја запознае како Мајка Тереза.

Особената вредност на ова дело лежи во фактот што повторно го враќа читателот кон изворите од самото време, таму каде што Гонџе сè уште не

беше светицата на човештвото, туку една албанска девојка од Скопје, која со целото свое срце ја бараше Божјата волја и се подготвуваше да одговори на Неговиот повик.

Долги години бев убеден дека, за целосно да се разбере патот што Гонџе Бојациу го изоде од Скопје кон мисијата, не се доволни само подоцнежните сеќавања или ретроспективните биографии. Токму затоа му предложив на историчарот проф. д-р Скендер Асани да ги истражи, систематизира и објави написите од списанијата Katoličke Misije и Blagovest, бидејќи токму во нив се зачувани најавтентичните сведоштва за раѓањето и развојот на нејзиниот мисионерски повик.

Денес, гледајќи ја оваа книга непосредно пред нејзиното објавување, можам со целосна увереност да кажам дека оваа визија е реализирана на извонреден начин. Истражувањето е спроведено со научна прецизност, со целосна верност кон изворите и со особена чувствителност кон духовната димензија што проникнува низ секој документ од овој период.

Оваа книга убедливо покажува дека „Katoličke Misije“ и „Blagovest“ не биле само две информативни списанија за црковниот живот. Тие претставувале две вистински школи за мисионерско формирање, кои ја обликувале свеста на младите генерации со идеалот за дарување на сопствениот живот за Христос и за најсиромашните во светот.

Токму на нивните страници Гонџе Бојациу се запознала со сведоштвата на мисионерите, со страдањата на далечните народи и со идеалот на апостолската служба, кој подоцна созреал во нејзината одлука да стане мисионерска сестра.

Затоа, најголемата заслуга на ова дело е што со документарни аргументи докажува дека овие две списанија не биле само извори на информации за мисиите, туку и составен дел од духовното обликување на Гонџе. Подоцна тие станале и местото каде што биле објавувани нејзините писма од Даблин и Индија, создавајќи ретко историско и духовно продолжение меѓу младата читателка што се вдахновувала од нивните страници и мисионерката која, преку сведоштвото на својот живот, ќе инспирира цели генерации.

Често сум истакнувал дека Гонџе Бојациу, шест години по ред, била верна поклоничка на Пресвета Богородица од Летница. Таа одела таму од две причини што ја следеле во текот на целиот нејзин живот.

Првата причина била здравствена. Таа боледувала од маларија, а само во климата на Летница дишела послободно, не само со своите бели дробови,

туку и со својата душа.

Втората причина била многу подлабока: потрагата по сопствениот повик. Пред ликот на Пресвета Богородица таа се молела со прашањето што ја придружувало низ целата нејзина младост:

„Ти ми го подари животот; што сакаш јас да направам со мојот живот?“

Тоа не било прашање на обична девојка, туку молитва на срце што ја барало единствено Божјата волја.

Ноќта на 14 август 1928 година, во пресрет на празникот на Пресвета Богородица од Летница, Гонџе запалила свеќа и, клекната пред нејзиниот лик, ја донела одлуката што ќе го промени не само нејзиниот живот, туку и историјата на христијанската љубов во дваесеттиот век:

„Сакам да станам мисионерска сестра за да им служам и да им помагам на најсиромашните во светот.“

Тоа бил мигот кога нејзиниот повик станал конечна одлука.

Веста за оваа одлука најнапред му ја доверила на својот братучед Лоренц Антони, а потоа и на мојата тетка Мрика Ѓерѓи, која ова сведоштво го чувала како света спомен-успомена.

Токму тука се спојуваат духовното искуство на Летница и историското сведоштво што оваа книга со толкава внимателност го претставува: одлуката на Гонџе не се родила во еден изолиран момент, туку созревала со години преку молитвата, црковниот живот, Маријанската конгрегација и мисионерската култура што се пренесувала преку страниците на „Katoličke Misije“ и „Blagovest“.

Од историографска гледна точка, ова дело претставува нов и значаен придонес во проучувањата за Мајка Тереза. Авторите не ги градат своите толкувања врз легенди, туку врз документи; не го читаат нејзиниот живот од крајот кон почетокот, туку од почетокот кон неговото исполнување. Токму тоа е патот на вистинското научно истражување.

Изворите не се користат за да потврдат однапред поставена теза, туку токму тие самите ја создаваат историската теза. Поради тоа, оваа книга не е само збирка документи, туку и методолошки модел на современата историографија, во која историјата повторно се гради врз автентичното сведоштво на своето време.

Најголемата вредност на ова дело лежи во тоа што не ни покажува само што направила Мајка Тереза, туку пред сè ни помага да разбереме како станала Мајка Тереза.

Помеѓу албанската девојка која во 1928 година го напушта железничката станица во Скопје и светицата која подоцна ќе ја допре совеста на целото човештво, постои еден невидлив мост. Тој мост е изграден од семејството Бојациу, од Црквата „Пресвето Срце Исусово“, од Маријанската конгрегација, од Светилиштето на Богородица во Летница и од мисионерската култура што се развивала и се пренесувала преку страниците на „Katoličke Misije“ и „Blagovest“.

Токму тој мост авторите успеале повторно да го изградат со исклучителна научна компетентност и со восхитувачка духовна чувствителност.

Во таа смисла, пред нас не стои само издание на документи, туку значаен чин на црковното, националното и научното паметење. Ова дело ѝ го враќа на историјата нејзиниот автентичен глас и сведочи дека Мајка Тереза не се родила случајно.

Таа се формирала во духовно богата средина, во семејство со жива вера, во заедница што го живеела Евангелието и во мисионерска култура која го хранела идеалот за дарување на животот за другите.

Убеден сум дека оваа книга ќе заземе значајно место во меѓународната библиографија посветена на Мајка Тереза. Таа ќе им служи на историчарите, теолозите, истражувачите на мисиите, но и на секој читател што сака да ја запознае документарната вистина за патот на Гонџе Бојациу.

Тоа е дело што му го враќа достоинството на историскиот извор, ја збогатува албанската и балканската историографија и, истовремено, претставува драгоцен придонес за Црквата во зачувувањето на сопственото историско и духовно паметење.

Затоа, со особено задоволство и со целосно убедување го поздравувам објавувањето на ова дело и го препорачувам како референтна научна студија за сите оние што сакаат да го запознаат вистинскиот почеток на мисионерскиот пат на Гонџе Бојациу.

Враќајќи се кон автентичните извори, авторите убедливо покажуваат дека историјата на Мајка Тереза не започнува во Калкута, туку во Скопје, во Летница, на страниците на „Katoličke Misije“ и „Blagovest“, токму таму каде што било посеано семето на еден повик што подоцна ќе прерасне во универзална мисија на љубовта, милосрдието и служењето на целото човештво.

Летница, 6 август 2026 год.

REVIEW

RETURNING TO THE SOURCES - RETURNING TO THE TRUTH OF A VOCATION

On the book:The Missionary Journey of Gonxhe Bojaxhiu toward the Universal Mother Teresa (Katoličke Misije and Blagovest)

Don Lush GJERGJI

There are books that narrate history, and there are books that restore history to its original voice. The volume by Skender Asani, Albert Ramaj, and Sevdail Demiri, Katoličke Misije and Blagovest: Documenting the Transformation of Gonxhe Bojaxhiu into the Universal Mother Teresa, belongs to the latter category. It is not merely a presentation of historical facts, but a scholarly work that brings back to light the authentic sources upon which historical truth is built.

This is far more than a documentary publication. It is a rigorous academic study grounded in historiographical research, critical analysis, and a profoundly human and spiritual interpretation of the two most influential Catholic periodicals of their time Katoličke Misije and Blagovest. Long before the world came to know Gonxhe Bojaxhiu as Mother Teresa, these journals became the first chroniclers of her missionary journey.

The enduring value of this work lies precisely in its ability to return the reader to the contemporary sources themselves to the time when Gonxhe was not yet the universally revered saint of humanity, but rather a young

Albanian woman from Skopje, wholeheartedly seeking the will of God and preparing herself to respond to His call.

For many years I have been convinced that a full understanding of Gonxhe Bojaxhiu‘s journey from Skopje to the missionary vocation could not be achieved solely through later memoirs or retrospective biographies. It was for this very reason that I encouraged the historian Prof. Dr. Skender Asani to research, systematize, and publish the articles contained in Katoličke Misije and Blagovest, for within their pages are preserved the most authentic testimonies concerning the birth and development of her missionary vocation.

Now, as I have the privilege of seeing this volume on the eve of its publication, I can affirm with complete confidence that this vision has been realized in an exemplary manner. The research has been conducted with exemplary scholarly precision, unwavering fidelity to the historical sources, and a remarkable sensitivity to the spiritual dimension that permeates every document from this formative period.

This book convincingly demonstrates that Katoličke Misije and Blagovest were far more than informative Catholic journals. They were genuine schools of missionary formation, nurturing the conscience of a new generation with the ideal of dedicating one‘s life to Christ and to the poorest of the poor. Within their pages, Gonxhe Bojaxhiu first encountered the testimonies of missionaries, learned of the suffering of distant peoples, and embraced the apostolic ideal of service an ideal that would later mature into her decision to become a missionary sister.

The greatest achievement of this work is that it demonstrates, through compelling documentary evidence, that these two journals were not merely sources of missionary information but integral elements in Gonxhe‘s own spiritual formation. Later, they also became the very publications in which her letters from Dublin and India appeared, creating a remarkable continuity between the young reader who once drew inspiration from their pages and the missionary who, through the witness of her own life, would go on to inspire generations throughout the world.

I have often affirmed that Gonxhe Bojaxhiu, for six consecutive years, was a faithful pilgrim to the Shrine of Our Lady of Letnica. She journeyed there for two reasons that would accompany her throughout her entire life.

The first was related to her health: she suffered from malaria, and only in the climate of Letnica could she breathe more freely both physically and spiritually. The second reason was far deeper: the search for her vocation. Before the image of the Blessed Virgin, she prayed with the question that accompanied her throughout her youth:

„You have given me life; what do You want me to do with my life?“

This was not the question of an ordinary young woman; it was the prayer of a heart seeking nothing but the will of God.

On the night of 14 August 1928, the vigil of the Feast of Our Lady of Letnica, Gonxhe lit a candle and, kneeling before the image of the Blessed Virgin, made the decision that would transform not only her own life but also the history of Christian charity in the twentieth century:

„I want to become a missionary sister in order to serve and help the poorest people in the world.“

It was at that moment that her vocation became a definitive commitment.

She first entrusted this decision to her cousin Lorenc Antoni, and later to my aunt, Mrika Gjergji, who preserved this testimony throughout her life as a sacred memory. Here, the spiritual experience of Letnica converges with the historical evidence so carefully presented in this volume. Gonxhe‘s decision was not born in an isolated moment of inspiration; rather, it had been nurtured over many years through prayer, ecclesial life, the Marian Congregation, and the missionary culture fostered by the pages of Katoličke Misije and Blagovest.

From a historiographical perspective, this volume represents a significant and original contribution to Mother Teresa studies. The authors do not construct interpretations upon legends but upon documents. They do not read her life retrospectively from its culmination back to its beginnings but instead follow its authentic historical development, from its origins to its fulfillment. This is the true path of scholarly historical inquiry.

The sources are not employed merely to support a preconceived thesis; rather, they themselves give rise to the historical argument. For this reason, the book is much more than a documentary collection. It serves as a methodological model of contemporary historiography, demonstrating how history can be reconstructed through the authentic testimony of its own time.

Perhaps the greatest merit of this work is that it does not simply tell us what Mother Teresa did, but, above all, helps us understand how she became Mother Teresa.

Between the young Albanian girl departing from the railway station in Skopje in 1928 and the saint who would later touch the conscience of the entire world, there exists an invisible bridge. That bridge was built by the Bojaxhiu family, the Church of the Sacred Heart of Jesus, the Marian Congregation, the Shrine of Our Lady of Letnica, and the missionary culture nourished through the pages of Katoličke Misije and Blagovest.

It is precisely this bridge that the authors have reconstructed with outstanding scholarly competence and admirable spiritual sensitivity.

In this sense, what we have before us is not merely a publication of historical documents, but an important act of ecclesial, national, and scholarly remembrance. This work restores history to its original voice and demonstrates that Mother Teresa did not emerge by chance. She was formed within a spiritually rich environment, in a family of living faith, within an ecclesial community that embodied the Gospel, and within a missionary culture that nurtured the ideal of dedicating one's life to the service of others.

I am convinced that this volume will occupy an important place in the international bibliography devoted to Mother Teresa. It will serve historians, theologians, scholars of missionary studies, and every reader who seeks to understand the documentary truth of Gonxhe Bojaxhiu's journey. It is a work that restores the dignity of historical sources, enriches Albanian historiography, and at the same time offers the Church a valuable contribution to the preservation of its own historical memory.

For these reasons, I warmly welcome the publication of this remarkable volume and wholeheartedly recommend it as an authoritative reference study for all who wish to discover the authentic beginnings of Gonxhe Bojaxhiu's missionary vocation.

By returning to the original sources, the authors convincingly demonstrate that the story of Mother Teresa does not begin in Calcutta. Rather, it begins in Skopje, in Letnica, and within the pages of Katoličke Misije and Blagovest, where the seed of a vocation was first sown a vocation that would ultimately blossom into a universal mission of love, mercy, and service to all humanity.

This work is therefore much more than a contribution to historical scholarship. It is an invitation to rediscover the origins of a vocation that transformed the twentieth century and continues to inspire the conscience of our own time. It reminds us that every great mission begins in silence, every authentic vocation is born through faithful discernment, and every enduring act of charity is rooted in the courageous response to God's call.

In restoring the earliest documentary testimony of Gonxhe Bojaxhiu's missionary formation, the authors have not only enriched the historical record but have also illuminated the spiritual path that led a young Albanian woman from Skopje to become one of the most universally revered figures of modern history. Their work stands as an exemplary synthesis of rigorous historiography, critical source analysis, and profound theological insight.

For this reason, I consider this publication to be a landmark contribution to Mother Teresa studies and a lasting point of reference for future generations of scholars. It is a work worthy of international recognition, for it restores to history its authentic foundations and, through them, allows us to encounter anew the truth of one of humanity's greatest witnesses to faith, charity, and selfless service.

Letnica, 6 August 2026

RECENSION

DOKUMENTET NËN HIJEN E HESHTJES

Mbi librin: "Udha misionare e Gonxhe Bojaxhiut drejt Nënë Terezës universale ("Katoličke Misije" dhe "Blagovest")"

Prof. Dr. Martin BERISHAJ

Shumica e librave për personalitetet e mëdha fillojnë aty ku historia tashmë ka dhënë verdiktin e saj. Fillojnë nga fama, nga njohja universale, nga momenti kur një emër ka hyrë në kujtesën kolektive të njerëzimit. Kështu ka ndodhur edhe me Nënë Terezën. Për dekada me radhë, studiuesit kanë shkruar mbi shenjtoren, laureaten e Çmimit Nobel, simbolin botëror të mëshirës, humanisten që ndërroi mënyrën se si bota e kupton dinjitetin e njeriut.

Por historia nuk fillon aty ku fillon kujtesa, ajo fillon shumë më herët në çastin kur askush ende nuk e di se po lind historia. Prandaj, ky libër është ndërtuar mbi këtë dallim themelor.

Në historiografi ekziston një parim i heshtur, por vendimtar: sa më afër ngjarjes të jetë burimi, aq më larg është ai nga miti. Pikërisht për këtë arsye dokumenti nuk është thjesht bartës informacioni; ai është forma më e afërt që njeriu ka krijuar për ta ruajtur kohën. Dokumenti nuk kujton. Dokumenti dëshmon dhe dëshmia ka një forcë që asnjë interpretim i mëvonshëm nuk mund ta zëvendësojë.

Ky tekst nuk kërkon të tregojë se kush ishte Nënë Tereza. Bota këtë e di. Ai kërkon të shpjegojë një pyetje shumë më të vështirë: Si bëhet e mundur lindja e një personaliteti universal?

Asnjë shenjtore nuk lind shenjtore. Asnjë humanist nuk lind humanist. Asnjë figurë universale nuk lind universale. Sepse çdo universalitet fillon si histori lokale. Çdo mision fillon si një vendim i heshtur. Çdo transformim fillon në një hapësirë që, në çastin kur ndodh, askush nuk e konsideron historike.

Prandaj ky libër nuk fillon në Kalkutë. As në Oslo. As në Vatikan. Ai fillon në arkiv.

Sepse përpara se të ekzistonte figura publike, ekziston dokumenti. Në një kuptim më të thellë, ky nuk është vetëm një libër për Nënë Terezën. Është një libër për mënyrën se si lind historia, sepse ajo nuk ndërtohet nga kujtesa kolektive. Historia ndërtohet nga gjurmët që koha lë pas vetes.

Fotografitë, letrat, revistat, raportet, dorëshkrimet, artikujt e harruar. Këto nuk janë vetëm materiale arkivore. Janë fosilet e kujtesës njerëzore. Dhe, ashtu si paleontologu rindërton një botë të zhdukur nga një fragment kocke, autori rindërton një epokë nga një copë letër. Ky është akti që përpiqet të realizojë ky libër. Në këtë perspektivë, Katoličke Misije dhe Blagovest nuk janë më vetëm dy revista katolike të Ballkanit. Ato shndërrohen në laboratorin ku historia regjistroi, pa e ditur, lindjen e një ndërgjegjeje universale. Kur ato botonin letrat e Gonxhe Bojaxhiut, askush nuk mund ta imagjinonte se po dokumentonte jetën e një gruaje që do të prekte ndërgjegjen morale të shekullit XX. Kjo është madhështia e burimeve parësore. Ato nuk shkruajnë për të famshmit. Ato shkruajnë për njerëzit, përpara se historia t'i bëjë të famshëm. Dhe pikërisht për këtë arsye ato janë më të besueshme se çdo biografi e shkruar dekada më vonë.

Në shkencat historike ekziston një dallim i madh ndërmjet historisë së kujtuar dhe historisë së dokumentuar. Historia e kujtuar ndërtohet nga memoria. Historia e dokumentuar ndërtohet nga koha.

Ky libër zgjedh kohën

Ai zgjedh të dëgjojë zërin e vitit 1928, jo interpretimin e vitit 2028. Ai zgjedh ta ndjekë Gonxhen kur ende ishte vetëm Gonxhe. Kur ende nuk ekzistonte miti. Kur nuk kishte Nobel. Kur nuk kishte shenjtërim. Kur nuk kishte miliona admirues. Vetëm një vajzë shqiptare nga Shkupi, që largohej drejt një bote të panjohur. Dhe dy revista që e shënonin këtë largim me qetësinë e zakonshme të kronikës.

Në këtë kuptim, ambicia e këtij libri nuk është të shkruajë edhe një biografi për Nënë Terezën. Ambicia e tij është shumë më e madhe. Të rikthejë dokumentin në vendin që i takon. Sepse vetëm dokumenti na lejon ta shohim historinë përpara se ajo të bëhet legjendë. Vetëm dokumenti na lejon ta kuptojmë se universaliteti nuk lind nga fama.

Ai lind nga besnikëria ndaj një thirrjeje.

Dhe vetëm dokumenti na mëson se, shumë kohë përpara se njerëzimi ta njihte emrin Nënë Terezë, historia kishte filluar tashmë ta shkruante atë.

Historia fillon aty ku askush nuk e di se po lind historia

Ekzistojnë figura të rralla, jeta e të cilave nuk i përket më vetëm kohës në të cilën kanë jetuar, as popullit prej të cilit kanë dalë dhe as traditës fetare që i ka formuar. Me kalimin e kohës, ato bëhen pjesë e ndërgjegjes universale të njerëzimit. Emri i tyre pushon së qeni vetëm emër dhe shndërrohet në simbol; jeta e tyre nuk lexohet më si biografi, por si një paradigmë morale. Nënë Tereza është njëra prej këtyre figurave të jashtëzakonshme. Ajo i përket atij rrethi të vogël personalitetesh, ndikimi i të cilave nuk matet me pushtetin që ushtruan, me territorin që sunduan apo me veprat që ndërtuan, por me aftësinë për të ndryshuar mënyrën se si njerëzimi e kupton dinjitetin e njeriut. Megjithatë, sa më universale të bëhet një figurë historike, aq më i madh bëhet rreziku që historia e saj të zëvendësohet nga kujtesa kolektive, ndërsa dokumenti nga rrëfimi. Pikërisht këtu fillon sfida e historianit. Historia nuk është kujtesë. Historia nuk është traditë. Historia nuk është as adhurim. Historia është rikthim i vazhdueshëm te burimet. Ky është edhe themeli epistemologjik mbi të cilin është ndërtuar ky libër.

Shumica e studimeve mbi Nënë Terezën janë shkruar pasi bota e kishte njohur tashmë madhështinë e saj. Ato e shohin jetën e saj nga fundi drejt fillimit. Nisen nga laureatja e Çmimit Nobel për Paqen, nga themeluesja e Misionareve të Bamirësisë, nga shenjtorja e Kishës Katolike, dhe më pas përpiqen të rindërtojnë rrugën që e çoi deri aty. Por historia autentike nuk ecën kështu. Ajo nuk fillon nga fundi. Ajo fillon nga çasti kur askush ende nuk e di se po lind historia. Prandaj ky libër nuk fillon me Nënë Terezën. Ai fillon me Gonxhe Bojaxhiun. Jo me figurën universale, por me vajzën shqiptare nga Shkupi, emri i së cilës në fund të viteve njëzet nuk kishte asnjë domethënie tjetër veç asaj që kishte për familjen, bashkësinë katolike dhe qytetin ku ishte rritur. Kjo zgjedhje nuk është vetëm kronologjike, ajo është metodologjike sepse historia nuk duhet të lexojë të kaluarën me dijen e së tashmes.

Ajo duhet të rikthehet në kohën kur e ardhmja ishte ende e panjohur. Në këtë pikë qëndron edhe veçantia e këtij hulumtimi të autorit Dr. Skender Hasanit. Ai nuk është një përpjekje për të shkruar edhe një biografi të re mbi Nënë Terezën. Në historiografi ekziston një rregull i pashkruar: sa më afër ngjarjes të jetë dokumenti, aq më larg është ai nga miti. Dokumenti nuk ka nevojë të bindë askënd. Ai nuk shkruan për t'u bërë legjendë. Ai nuk e di se

çfarë do të ndodhë nesër. Pikërisht për këtë arsye ai mbetet forma më e pastër e së vërtetës historike.

Revistat Katoličke Misije dhe Blagovest, të cilat përbëjnë bazën dokumentare të këtij libri, kanë pikërisht këtë vlerë të jashtëzakonshme. Ato nuk shkruanin për shenjtoren që bota do të njihte shumë dekada më vonë. Ato shkruanin për një vajzë të re që largohej nga Shkupi për t'iu përgjigjur një thirrjeje misionare. Nuk kishte Nobel. Nuk kishte kanonizim. Nuk kishte famë botërore. Kishte vetëm një rrugëtim, një bindje të thellë shpirtërore dhe një seri dokumentesh që e regjistronin këtë rrugëtim në kohën kur ai po ndodhte. Pikërisht kjo i bën këto burime të pazëvendësueshme. Ato nuk e ndërtojnë historinë. Ato e ruajnë atë.

Në filozofinë bashkëkohore të historisë është pohuar se dokumenti nuk është vetëm një gjurmë e së kaluarës; ai është vetë prania e së kaluarës në kohën tonë. Çdo letër, çdo kronikë, çdo fotografi dhe çdo artikull i botuar në vitet 1928–1935 përfaqëson një copëz kohe që i ka mbijetuar harresës. Dokumenti nuk na tregon vetëm se çfarë ndodhi; ai na lejon të shohim botën ashtu siç e shihnin bashkëkohësit. Pikërisht për këtë arsye, ky libër nuk ndërton një rrëfim retrospektiv. Ai rindërton kohën.

Në faqet që pasojnë, lexuesi nuk do të ndeshet me një figurë të idealizuar. Ai do të takojë Gonxhen përpara se bota ta njihte si Nënë Terezë. Do ta shohë teksa largohet nga familja, hyn në Kongregatën e Loretos, udhëton drejt Irlandës, mbërrin në Indi dhe fillon të zbulojë misionin që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës. Por ky libër nuk është vetëm histori e një individi. Ai është edhe histori e një bashkësie. Historia e Nënë Terezës nuk fillon në Kalkutë. Ajo fillon në Shkup. Fillon në familjen Bojaxhiu. Fillon në Kishën e Zemrës së Krishtit. Fillon në Kongregatën Mariane. Fillon në kulturën shpirtërore të katolikëve shqiptarë të Shkupit.

Dhe fillon në faqet e dy revistave që, pa e ditur, po dokumentonin lindjen e një prej figurave më të rëndësishme morale të shekullit XX. Në këtë kuptim, ky hulumtim tejkalon kufijtë e biografisë. Ai është një studim mbi mënyrën se si lind universaliteti. Sepse universaliteti nuk lind në qendrat e mëdha të historisë. Ai lind në heshtje. Lind në familje. Lind në komunitete të vogla. Lind në ndërgjegjen e njerëzve që zgjedhin t'i shërbejnë tjetrit pa kërkuar lavdi dhe vetëm shumë më vonë historia e kupton madhështinë e atij vendimi.

